

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development

Nr. Prot. 0113
 Br. Prot. 2153
 Prot. No. 13.09.19
 Data
 Datum
 Date: 13.09.19
 PRISHTINË/A

REGIONAL WATER SUPPLY
 PRISHTINA
 PRISHTINE
 Nr. 1543 Dt. 12 SEP 2019

KOMPANIA UJESJELLESËSI RAJONAL SH.A.
 REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA

Raporti i tre mujorit te II-të për vitin 2019

Vendimi : 2019 /09-06

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e III të rregullt të mbajtur me dt.06/09/2019 pas shqyrtimit të raporteve për TM 2, miratoi njëzëri raportin e TM -2 për 2019, dhe i njëjti Raport të përcillet në NJPMNP si dhe Komunave ne zonën e shërbimit.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi: Ilir Avdullahu	Kryesuesi i BD: Betim Berisah
Nënshkrimi		
Data	06.09.2019	06.09.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development

Niviu Org. / Org. Jedin / Org. Unit: 01/3 Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 2153
 Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 1 Data / Datum / Date: 13.09.19
 PRISHTINË/A

REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE
PRISHTINA
 PRISHTINE
 Nr. 1543 Dt. 12 SEP 2019

KOMPANIA UJESJELLESIA RAJONAL SH.A.
 REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të KRU "PRISHTINA" SH.A të mbajtur me 06.09.2019 mbledhja e 9-të e rregullt e KRUP për vitin 2019.

Bordi i Drejtorëve, pas analizave të bëra të rekomandimeve që KA i përcjell në këtë mbledhje të rregullt të BD. Andaj BD duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga KA dhe mbi raportin e ZAB-it pra merr këtë:

V e n d i m 2019/09-04

1. Aprovohet rekomandimi nga Komiteti i Auditimit, KA në mbledhjen se 8 të rregullt të KA të mbajtur me 03.09.2019 ka trajtuar raportin financiar dhe operativ për muajin Qershor, TM 2 për vitin 2019 si dhe raportin e ZAB-it për Investimet Kapitale Janar 2017 – Dhjetor 2018 sipas planit vjetor të ZAB për vitin 2019.

Sekretari i Kompanisë
 Salih Gjonbalaj, Jur. i Dipl.





Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve:
 Betim Berisha





Prishtinë: 30.06.2019

Për: Analistnëdepartamentin e NJPMNP
z. AdemAhmetaj

Nga: Salih Gjonbalaj, Sekretarë KRU "PRISHTINA" SH.A
Kopje: Ilir Abdullahu, Kryeshef EkzekutiviKRU "PRISHTINA" SH.A.

Tema: PËRMBUSHJA E PËRGJEGJËSIVE NGA NENI 31 I LIGJIT MBI NP-të PËR TM2

Data: 30.06.2019

RAPORT

PËRMBUSHJA E PËRGJEGJËSIVE NGA NENI 31 I LIGJIT MBI NP-të

Me qëllim që të permbushim përgjegjësinë ligjore të përcaktuar me nenini 31 të Ligjit mbi Ndermarrjet Publike, të cilat obligohen të raportojnë çdo tremujor për rezultatet e arritura në afarizëm për periudhën raportuese. Jemi në dijeni se raportimi nga e kaluara nuk ka permbajtur të gjitha këto kërkesa të cilat tani kërkon NJPMNP, por do të mundohemi që nga ky raport që tani do ta perpilojmë, do të veprojmë edhe herave tjera dhe raportet e ardhëshme do të jenë në perputhje të plotë me kërkesat e Ligjit.

Bazuar në kërkesën e Ligjit mbi NP, tani e tutje ne do të raportojmë për:

- Struktura organizative e Ndermarrjes Publike, e aprovuar për vitin aktual (duke përfshi strukturën e mëparshme organizative dhe ndryshimet e reja që janë bërë në organogramin e ri të KRU "Prishtina" sh.a.)
- Performanca afariste dhe financiare gjatë tre muajve përkatës,
- Përmbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore ose arbitrazhit të pambaruara ose të kërcnuara për mos permbarim, që kërcenojnë NP.
- Përshkrim i procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cilat NP pritet ti inicojë gjatë tremujorit aktual.
- Transakcionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse,
- Propozime për rritje të performancës së NP.

Kërkesa tjera të specifikuar dhe që kërkojnë nga NJPMNP janë:

(këto dokumente të theksuara më poshtë jua kemi dërguar me postë elektronike dhe kopje të fortë fizike)

- Pasqyra e të ardhurave,
- Pasqyra e bilancit të gjendjes,
- Pasqyra e rrjedhës së parase
- Pasqyra e rrjedhës në ekuitet
- Shpalosja e shpenzimeve:
 - a) Shpenzimet e reprezentacionit për menaxhmentin dhe bordin,
 - b) Shpenzimet e derivateve,
 - c) Shpenzimet e veturave,

- d) Shpenzimet e telefonisë,
 - e) Shpenzimet tjera.
 - Lista e veturave për përdorim 24 orë.
 - Pasqyrat komplete duke përfshirë:
 - Pasqyrën e të ardhurave, të zërbërës në detaje-çdo lloj i të hyrave dhe shpenzimeve që kanë ndodhë gjatë 6 muajve 2019.
 - Bilanci i gjendjes i detajizuar,
 - Pasqyra e rrjedhës së parës.
- (të gjitha këto dokumente-pasqyra po ua dërgojmë në formë elektronike dhe do t'i mërrni edhe në kopje fizike)

Shpenzimet e derivateve:

- Bordi i drejtorëve ka pasur shpenzimet 0 (zero) për derivate,

Shpenzimet e menaxhmentit dhe të personelit tjetër teknik dhe administrativ, automjetet e transportit, makinat ingjinerike, kamionet dhe pajisjet tjera motorike kompanisë kanë shpenzuar 62,819 litra derivate, apo shprehur në vlerë monetare: 57,108€.

Shpenzimet e telefonisë mobile dhe fikse dhe internetit janë :10,742.00€

Shpenzimet tjera:

Kostoja e mirëmbajtjes dhe riparimit për 6 muajin 2019 janë 56,264.00€.

Vërejtje: të gjitha shpenzimet tjera që janë në interesin tuaj, mund t'i gjeni në Pasqyrën e të ardhurave të cilën ua kam bashkëngjitur, nëse keni ndonjë vështirësi për t'u shërbyer nga pasqyrat financiare ju lutemi na shkruani ose na kontaktoni për sqarime dhe shpjegime të formulaveve.

BILANCI I GJENDJES – 30.06.2019

Pershkrimi	Qershor-2019	31-Dhjetor-2018
Pasuritë	2,019	2,018
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	92,484,927	95,164,582
Investimet ne vijim		
Pasuritë jo qarkulluese	92,484,927	95,164,582
Stoqet Neto	1,535,928	1,604,359
Llogarite e arkëtueshme	14,440,187	14,023,536
Kërkesat tjera	1,769,695	1,828,423
Paraja dhe Ekuivalentet e Parasë	4,423,614	4,319,492
Te hyrat e shtyra nga grantet	1,282,251	
Totali- Pasuritë	115,936,602	116,940,392
Ekuitetii dhe Detyrimet		
Kapitali Aksionar	25,000	25,000
Rezervat	72,710,753	72,710,754
Fitimet-Humbjet e akumuluar	(10,320,773)	(9,569,759)
Fitimi/Humbja e vitit	70,581	(751,015)
Tatimi ne Fitim	7,842	
Total ekuiteti	62,493,403	62,414,980
Obligimet afatgjate lidhur me kredite dhe grantet e shtyera	51,213,480	52,311,203
Total detyrimet afatgjate	51,213,480	52,311,203
Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera	1,442,331	1,378,362
Tatimi i pagueshëm	787,388	835,847
Total detyrimet afatshurter	2,229,719	2,214,209
Total detyrimet	53,443,199	54,525,412
Total detyrimet dhe ekuitetit	115,936,602	116,940,392

PASQYRA E TË ARDHURAVE – 30.06.2019

Pershkrimi	Qershor-2019	31-Dhjetor-2018
	2019	2018
Të hyrat nga shërbimet e furnizimeve me ujë	7,154,370	14,267,001
Të hyrat tjera operative	81,461	43,539
Të hyrat nga grantet	1,267,071	2,149,196
TOTALI - Të hyrat operative	8,502,902	16,459,736
Shpenzimet operative		
Shpenzimet për blerje Uji të paperpunuar	(343,820)	(642,196)
Shpenzimet e energjise	(1,102,218)	(2,312,212)
Shpenzimet e karburanteve	(57,108)	(117,861)
Shpenzimet e personelit-paga dhe meditje	(2,723,361)	(5,137,160)
Shpenzimet materiale	(155,796)	(739,460)
Shërbimet e jashtme kontraktuese	(493,504)	(703,808)
Shpenzimet e takses së MMPH 2011-2017	-	(365,954)
Shpenzimet e rek., sportit, kultures dhe nd. solidarë	(3,418)	(7,642)
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit	(56,264)	(117,000)
Shpenzimet e zhvleresimit dhe amortizimit	(3,269,660)	(6,539,319)
Shpenzimet e provizionimit të borxhit të keq	(15,219)	(30,437)
Te dalurat financiare dhe transferi i rezultatit fin.	(1,827)	(24,128)
TOTALI - Shpenzimet operative	(8,222,194)	(16,737,177)
Fitimi-Humbja operative	280,708	(277,441)
Të hyrat nga interesi në depozitat bankare	15,180	13,063
Shpenzimet e interesit	(217,465)	(486,637)
Fitimi-Humbja para tatimit	78,423	(751,015)
Tatimi në fitim	(7,842)	
Fitimi / Humbja e vitit	70,581	(751,015)

RRJEDHA E PARASË – 30.06.2019

Pershkrimi	30.Qershor.2019	TOTALI
	2019	2018
Aktiviteti operativ		
Të hyrat	7,223,921	
Shitjet e faturuara v. themelore	11,910	
Të hyrat tjera		
Totali-Të hyrat e faturuara		7,235,832
Llogarit e arkëtueshme dhe parapagimet		
Stoqet	68,431	
Llogarit e arkëtueshme	(431,870)	
Kerkesat tjera afatshkurtera	58,728	
Total stoqet dhe kerkesat tjera		(304,711)
Pagesat		
Shpenzimet operative	(5,154,782)	
Total - Shpenzimet		(5,154,782)
Detyrimet		
Obligimet afatgjata	(1,295,357)	
Llogarit e pagueshme	63,970	
Tatimi ne fitim		
Tatimi i pagueshem	149,176	
Total-Detyrimet		(1,082,212)
Rjedha e parasë nga aktiviteti operativ		
Total-Aktivitetet investuese		
Mjetet jo qarkulluese	(590,005)	
Pagesat e parase per kryegjen e kredise dhe fleteobligacioneve		
Interesi në depozita		
Total-Rjedha e parasë nga aktiviteti investues		(590,005)
Aktivitetet financuese		
Grantet e shtyera		
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financues		
Rrjedha neto e parasë		104,122
Bilanci fillestar në para të gatshme		4,319,492
Bilanci përfundimtar në para të gatshme		4,423,614

EKUITETI – 30.06.2019

Pershkrimi	Me 01 Janar 2019	Me 30.06.2019
	2019	2019
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat kapitale	72,710,754	72,710,753
Fitimet (Humbjet) e akumuluar	(9,569,759)	(10,320,773)
Fitimi /humbja e vitit	(751,015)	70,581
Totali		7,842
TOTALI - Me 30 Qershor 2019	62,414,980	62,493,403

Struktura organizative e Ndermarrjes Publike, e aprovuar për vitin aktual (duke përfshirë strukturën e mëparshme organizative dhe ndryshimet e reja që janë bërë në organogramin e ri të KRU "Prishtina" sh.a.)

Në vazhdim do ta japim Strukturën organizative-Organogramin e NP: KRU "Prishtina" sh.a. me të cilën strukturë organizative ka punuar kompania vitet e mëparshme, në të njetën kohë do të bashkëngjeshim edhe organogramin me të ri të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe më këtë strukturë të re organizative. KRU "Prishtina" sh.a. është duke punuar tash e gjashtë muaj prej kur ka filluar se zbatuari struktura e re organizative e cila po shifet se është mjaftë funksionale dhe po jep efektet e para pozitive.

- Bordi i Drejtorëve me komitetet e saj kanë pësuar ndryshime ku kemi Bord të Drejtorëve të ri që është zgjedhur dhe zëvendësuar me një tjetër me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, vendimi nr.08/107 datë 18.06.2019 plotësim ndryshimi i bërë në muajin Qershor 2019 pra në TM 2.
 - a) Struktura Organizative për 2019 e aprovuar përmbanë gjithësej 14 departamente dhe dy zyra.
 - b) Ka edhe ndryshime tjera të cilat janë në nivele ma të ulëta që nga sherbimet, sektoret, njësitë dhe pozicionet e ndryshme të vendeve të punës të cilat kanë pësuar ndryshime në pershkrim dhe detyra të punës.
- a) KRU "Prishtina" sha nuk ka bere ndryshime ne kete 6 mujore të parë të 2019. Struktura e re organizative,
- b) Pershkrimi i ri i vendeve të punës,
- c) Aplikimi i Sistemit të ri i llogaritjes dhe pagesës së pagave,
- d) Nivelizimi i pagave dhe sistematizimi i vendeve të punës,
- e) Kontratat e reja të punëtorve sipas Ligjit të Punës,
- f) Rregullorja e punës dhe pagesa sipas rezultateve të punës,
- g) Nderprerja e të gjitha formave të tjera të punësimit, perveq konkursit etj.

Analizë e parametrave kryesor dhe raporti i të dhënave si dhe treguesve kryesor të performancës së KUR "Prishtina" sh.a. dhe njësive.

➤ *Uji i prodhuar*

Është evidentuar një rënje e vogël e prodhimit në raport me planin, kjo rënje rreth - 6%. Plani i prodhimit ka patur një ngritje të vogël në krahasim me vitin paraprak, kjo ka ndodh për faktin se është arritur në maksimumin e mundshëm apo në kapacitetet teknike të instaluar mbi të cilat nuk mund të dilet. Vazhdimi eventual i reshjeve, do të rrisë sasinë e ujit të prodhuar, por sigurisht do të ndikojë edhe në rritjen e kohës së furnizimit të konsumatorëve me ujë të pijes. Duke përfillur kështu Standardet minimale të shërbimit kërkojnë furnizim 24 orë pa ndërprerje për qytetarët dhe të gjithë konsumatorët tjerë.

- *Uji i faturuar* – ka patur një rritje të lehtë plani, një realizim prej 99% më mirë se e njeta periudhë e vitit të kaluar për 3%. Kur marrim parasyshë aplikimin rigoroz të leximit me ujmatës apo sipas sasise së harxhuar nga konsumatorët, pastaj eliminimin e pjesërisht nga faturimi fiktiv dhe jo të matur, mund të konsiderojmë sukses edhe këto gjendje të faturimit.

- *Konsumator të regjistruar*, plan shumë ambicioz, por edhe realizim i plotë i cive dhe objektivave, mesatarisht 3% e numrit të konsumatorëve të regjistruar për çdo muaj më shumë se plani, kurse 5% konsumator të regjistruar më shumë se regjistrimi një viti më parë. Këtu kemi regjistruar një dinamikë shumë të lartë për 6 muaj të vitit. Kjo dinamikë sigurisht që nuk mund të mbahet për përpjekjet tona do të jenë që të regjistrohen të gjithë ata konsumator të cilët kanë kërkuar në rrjetin e ujësjellësit, por iu janë shmangur regjistrimit si konsumator dhe pagues të shërbimeve që i marrin nga kompania.

- *Faturat leshuara*, faturimi i mbështetur në lexim apo me ujmatës si dhe shtimi i numrit të konsumatorëve të ri është një prej treguesve më pozitiv që kemi evidentuar për gjysmëvitin e 2019. Numri i faturave mujore të leshuara ka qenë 136,919. Krahasimi i numrit të faturave të leshuara për muajin qershor 2019 në raport me faturat e qershor 2018 rezulton të jetë për 7,029 fatura më shumë se e njeta periudhë e vitit krahasues. Kjo ngritje e konsideruar e numrit të faturave është treguesi më i mirë i aktiviteteve të shtuara në gjetjen e faktoreve që po ndikojnë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

- *Faturimi dhe inkasimi*, Planifikimi real, ka tregu se duhet të kemi kujdes gjatë planifikimit, sepse pastaj do të ndeshemi me problem dhe pengesa të pakalueshme dhe të përzueshme. Të zvogëlsh humbjet brenda vitit me një shkallë të lartë, jo

vetem qe është ambicioze por thuajse edhe e pamundur te realizohet. Zvoglimi i humbjeve duhet te mbështetet me nje strategji shumë vjeqare dhe logjike te renjes se shkalles se humbjeve ndoshta me 1-2% brenda viti. Per te arritur qe pas dhjete viteve të arrijme humbjet totale te ujit ne 40%. Kushtet, rrethanat, infrastruktura, gjendja sociale e popullsesise është e tillë që veshtirë mund të zvoglohet në menyrë radikale humbja e ujit qoftë ajo për shkaqe teknike që vjen si pasojë e rrjetit dhe infrastruktures shumë të vjetër por edhe për shkakun e keqperdorimeve dhe vjedhjeve të ujit që bëhet nga konsumatorët. Megjithatë ne mund të inkurajohemi dhe të shprehim kenaqesinë tonë me shkallën e realizimit të gjashtë mujorit te vitit 2019 ne raport me vitin 2018. Realizimi është per 1% më shumë ujë të faturuar se sa viti paraprak.

- **Shpenzimet operative** janë afersisht të njejta me planin, perkunder asaj qe kemi patur rritje te pagave ne shkallen 4%, , derivative dhe rritjen e të gjitha çmimeve të materialeve dhe pjeseve reserve te cilat i perdorim gjate operimit te Kompanisë. Shpenzimet ishin te barabarta me planifikimin pak ma të larta se sa vitin e kaluar por më të ulëta se sa planifikimi, ndaj duhet te theksohet se jemi shume mire me shpenzime, gjejgesisht mbajtje ne nivel te njete vleror. Shpenzimet operative logjikisht është dashte te rriten, por racionalizimi i shpenzimeve, reduktimi i punes jashte orarit, zvoglimi i udhetimeve jashte vendit, renja e dukshme e pageses se meditjeve dhe udhetimeve zyrtare, vendosja e sistemit GPS, per automjetet e kompanise dhe zvoglimi shpenzime te tjera te mirmbajtjes dhe operatives kane ndikuar ne ruajtejn e nivelit te njete te shpenzimeve si ne periudhen e njete te vitit te kaluar.
- **Shpenzimet jooperative** janë nën nivelin e planifikuar, ky si tregues duket te jetë pozitiv por në fakt këto shpenzime eshtë më mirë të tejkalojnë planin. Do te duhej te ishte shumë mirë, sikur në realitet të ndodhte që planifikimi i investimeve dhe mirmbajtjes investive të ishte në një harmoni të tillë duke shpenzuar 100% paratë e planifikuara në këte pozicion. Në të vertetë shpenzimet e mirëmbajtjes edhe po shënuan rënje është mirë për kompaninë, por Investimet është mirë të realizohen në bazë të planit.
- **KESH-i (paraja e gatshme)** kompanisë, duket të jetë shumë i mirë ndaj para në llogaritë bankare kompania ka 123% me shume ne raport me vitin paraprak ndersa 76% me shume ne raport me planifikimin. Paraja e gatshme është 3,375,650.
- **Llogaritë e arketuesheme** trendi i ketyre llogarive është ne rritje te lehtë, perkunder rritjes se shkalles së inkasimit. Kategorite e konsumatoreve sidomos atyre shtepiak kane nivelin me te larte te borxheve. Shkalla e inkasimit te kjo kategori arrin shifren prej 89 %, ky indeks krahasu me planin shifet se është I arritshem plani dhe jemi aty tek vlerat e planifikuara, kur jemi te kjo kategori e konsumatoreve behen shume perpjekje per te permirsuar inkasimin por veshtire te arrihen rezultate te kenaqeshme kur kemi parasysh shkallen e varferise ne vend si dhe pamundesine e

inkasimit te borxheve te kjo kategori e konsumatoreve. Kemi inicu shume procese dhe konteste gjygsore me konsumatorët qe nuk paguajne, lende ne permbarues por rezultatet e deritanishme nuk tregojnë se mund te pritët inkasim i dhunshem apo me Gjygj i borgjeve te blersve te ujit te cilet nuk paguajne faturat mujore te sherbimit. Kurse sa iu perket dy kategorive tjera si bizneset dhe institucionet, duhet te shprehim kenaqesine me shkallen e realizimit e cila ne TM2 e vitit 2019 është regjistru ne 103% per bizneset e medha dhe 101% per institucionet. Nje ngecje ne realizim verehet edhe te bizneset e vogla te cilat paguajne vetem 96% te borxheve vjetore te tyre.

- **Llogaritë e pagueshme** janë normale per një Kompani e cila ka investime dhe pune ne process, tendere me kontraktore te cilet punojne me situacione dhe kemi pjese te puneve te cilat nuk jane paguar, pastaj pagat e punetoreve te llogaritura e te papaguara per muajin e fundit te vitit, fatura te furnitorve te ndryshem te cilet ende nuk kanë perfunduar projektet, tvsh e llogaritur per llogarite e arketueshme ne kete rast borxhelinjte e Kompanise per te cilet jane shperndare faturat por te njetit nuk jane paguar faturat, si dhe disa borxhe te kompanise per disa mekanizma institucional dhe biznesor te cilet kane hequr dore nga inkasimi i faturave te tyre, ose e kane deklaruar si donacion apo borxh te keq per ndermarrjen e tyre, kurse tek ne ka mbetur ende si evidence ne konton e llogarive te pagueshme.
- **Numri i punëtorve**, është nën planifikimin, kur jemi te kjo shifer mund te krenohemi se menaxhmenti i ri jo qe nuk e ka kaluar numrin e lejuar dhe te planifikuar me Plan te Biznesit por ka arrit të stabilizoj shifren e punesimt bile edhe ta mbaj nen shifren e lejuar.
- **Testet e planifikuara-analizat** kimike dhe baktereologjike nga laborator i janë realizu mbi planinifikimin, ketu duhet të theksojme perveq planit te permbushur 100%, kemi pasur edhe kualitet te ujit qe kemi furnizuar qytetaret. Cilesia e ujit është mbajtur permanent dhe ne parametra te larte te kualitetit si ne aspektin kimik ashtu edhe ne ate baktereologjik.
- **Nderprejet e ujit per konsumatorët**, thuajse ka vazhdu trendi i furnizimit i njete me nje vit ma pare. Perpjekjet jane qe koha e furnizimit te qytetareve me uje te rritet. Zgjerimi dhe rritja enorme e popullates ne pjeset urbane te qytetit por edhe ne ato periferike ka ndikuar qe koha e furnizimit me uje te mbahet ne nivel te nje viti ma pare por edhe me nje tendence te rritjes se kesaje kohe ne favor te rritjes se reduktimeve. Futja ne system I gypit magjstral për Fushë Kosovë ka rritur Kohen e furnizimit me uje dhe ka stabilizuar gjendjen dukshem ne kete pjese ku e mbulon KRU Prishtina.

*Bashkangjitur gjeni tabelen me të dhënat financiare dhe operative në kuadër të KRU
"Prishtina".sh.a*

RAPORTI MBI TE DHENAT DHE TREGUESIT KRYESOR TË PËRFORMANCËS	Janar - Qershor- 2018		Janar - Qershor- 2019	
	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
UJI I PRODHUAR	26,100,468	26,048,328	26,694,749	25,174,064
UJI I FATURUAR	11,812,928	10,829,556	11,258,059	11,138,554
KOSTO E UJIT TE PRODHUAR	0.19	0.18	0.18	0.19
KONSUMATORËT E REGJISTRUAR	146,343	143,415	145,806	150,673
NR. I FATURAVE TË LËSHUARA	130,491	129,890	135,086	136,919
NUMRI I KONS. QE FATUROHEN SIPAS LEXIMIT TE UJEMATESAVE	130,147	126,703	132,384	133,418
UJI I FATURUAR PER KONSUMATORËT ME UJEMATESA	12,229,739	10,461,069	11,725,307	10,806,966
FATURIMI NE EURO	7,472,783	7,081,794	7,405,435	7,133,878
INKASIMI NE EURO	6,610,726	6,797,183	6,797,850	6,625,852
TË HYRA TË TJERA OPERATIVE	157,319	81,521	154,292	96,641
SHPENZIMET OPERATIVE PA AMORTIZIM	4,966,406	4,692,622	4,862,672	4,729,851
SHPENZIMET PER FABRIKEN NE SHKABAJ-VONESA- SHTRABAK				207,466
SHPENZIMET E INTERESIT-KREDIA				217,465
TË HYRAT JO OPERATIVE	588,785	2,820	820,732	1,267,071
INVESTIMET KAPITALE	1,160,000	996,854	546,246	590,005
PARATË E GATSHME NË ARKE DHE NË BANKË	56,056	1,510,740	1,914,047	3,375,650
PARAJA E GATSHME - DONACIONET NGA QEVERIA DHE KOMUNA E PRISHTINES		3,218,034		1,047,964
STOQËT NE EURO		1,611,588		1,535,928
LOGARITË E ARKETUESHME (NGA FATURAT) NE EURO		47,386,595		47,839,147
LOGARITË TJERA TE ARKETUESHME NE EURO		350,451		344,349
LLOGARITË E PAGUESHME (KREDITORE)		926,605		1,442,331
NUMRI I PUNËTORËVE	560	545	584	576
NDËRPRERJET MESATARE TË UJIT	220,458	65,090	55,842	48,848
NUMRI TOTAL I TESTEVE TË REALIZUARA	6,500	6,636	6,800	6,845
NUMRI TOTAL I TESTEVE TE DESHTUARA	50	45	50	47
UJI I PAFATURUAR	55	58	58	56
PËRQINDJA E FATURIMIT	89	91	93	91
PËRQINDJA E KONSUMIMIT TË MATUR	100	98	104	97
PROPOCIONI I KONSUMATOREVE ME UJËMATESA	89	88	91	89
EFIKASITETI I STAFIT	3.83	3.80	4.01	3.82
SHKALLA E INKASIMIT (% TOTAL)	88.46	95.98	92	93
SHKALLA E INKASIMIT (% AMV)	85.00	91.85	89	89
SHKALLA E INKASIMIT (% BIS) TË VOGLA	87.24	106.29	96	96
SHKALLA E INKASIMIT (% BIS) TE MEDHA	96.51	94.39	96	103
SHKALLA E INKASIMIT (% INST)	98.26	107.40	99	101
NORMA E MBULESËS SE PUNËS	1.36	1.47	1.43	1.42
NORMA E PUNËS	1.54	1.53	1.55	1.53
SHPENZIMET OPERATIVE PËR KONSUMATORË	33.94	32.72	33.35	31.39

Performanca operative në njësitë e KUR "Prishtina" sh.a

Trendi i shpenzimeve operative dhe jo operative të kompanisë:

- **Të ardhurat e faturuara**, të gjitha kategoritë kemi patur një ngritje në planifikim, krahasu me realizimin e vitit paraprak perveq te amvisëritë ku kemi një zvoglim të planit dhe tejkalim te faturimit ne kategorine e amviserise prej mbi 5% . Plani i faturimit ishte jo edhe aq ambicioz, ishte bukur shumë i akceptueshëm dhe real. Objektivat e planit nuk u realizuan dhe u tejkaluan te kategoria e bizneseve të vogla, te medha dhe institucionet kurse te kategoria e amviserise kemi patur ngritje të konsideruar të shkallës së faturimit krahasuar me të njetën periudhë të vitit të kaluar.
- **Të ardhurat e inkasuara**, per të gjitha kategoritë e konsumatorëve janë më të uleta se sa perudha krahasuese apo viti i kaluar perveq kategorise kryesore pra amviserise e cila ka ngritje te konsiderueshme prej 6% ne krahasim me planin. Në total të ardhurat e inkasuara janë 3% € me pak se sa periudha e njejte e vitit paraprak, dhe planifikimit. Shkalla e inkasimit apo të ardhurat e inkasuara per Prishtinë ishin 101% është nivel ky i deshiruar. Realizimi 101% i inkasimit në institucione është i kenaqshem. Kjo % konsiderojmë se është e permiresuar. Po shpresomë se pjesa e dytë i vitit 2019 do të jetë i mirë në realizim për shkakun e borxheve të cilat i kanë institucionet.

KRU Prishtina,sh.a	Janar - Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
SHKALLA E FATURIMIT / INKASIMIT SIPAS KATEGORIVE	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	4,706,511	4,663,460	4,584,360	4,828,200
BIZNESET E VOGLA	864,449	799,820	946,943	759,941
BIZNESET E MËDHA	717,228	574,711	699,505	590,182
INSTITUCIONET	1,184,595	1,043,802	1,174,626	955,555
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	7,472,783	7,081,794	7,405,435	7,133,878
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	4,000,440	4,283,616	4,057,642	4,317,521
BIZNESET E VOGLA	754,143	850,103	906,137	730,349
BIZNESET E MËDHA	692,209	542,450	668,186	608,108
INSTITUCIONET	1,163,934	1,121,014	1,165,885	969,874
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	6,610,726	6,797,183	6,797,850	6,625,852
SHKALLA E INKASIMIT	88%	96%	92%	93%
SHKALLA E INKASIMIT (% AMVISËRI)	85%	92%	89%	89%
SHKALLA E INKASIMIT (% BIZNESET) TË VOGLA	87%	106%	96%	96%
SHKALLA E INKASIMIT (% BIZNESET) TË MËDHA	97%	94%	96%	103%
SHKALLA E INKASIMIT (% INSTITUCIONET)	98%	107%	99%	101%

Njësia Prishtinë

- **Të ardhurat e faturuara**, të gjitha kategoritë kemi patur një ngritje në planifikim, krahasu me realizimin e vitit paraprak perveq te amvisëritë ku kemi një zvoglim të planit apo rritje te realizimit ne vlera te konsiderueshme. Objektivat e planit nuk u realizuan dhe u tejkaluan te kategoria e bizneseve të vogla, dhe institucioneve kurse te kategorita e amviserise kemi patur ngritje të konsideruar të shkallës së faturimit krahasuar me të njetën periudhë të vitit të kaluar, por ngecje apo mospermbushje të planit për vitin raportues.
- **Të ardhurat e inkasuara**, per të gjitha kategoritë e konsumatorëve janë më të uleta se sa perudha krahasuese apo viti i kaluar perveq tek kategoria e amviserise. Në total të ardhurat e inkasuara janë të përafërta me planin dhe periudha e njejte e vitit paraprak,. Shkalla e inkasimit apo të ardhurat e inkasuara per Prishtinë ishin 97% është nivel ky i deshiruar. Realizimi i inkasimit në institucione është i kenaqshem. Kjo % konsiderojmë se është e permiresuar. Po shpresomë se pjesa e dytë e vitit 2019 do të jetë i mirë në realizim për shkakun e borxheve të cilat i kanë institucionet.
- **Shpenzimet** janë 10% mbi planin, bazuar në rritjen e çmimeve të shërbimeve të tjera si Rryma, nafta, rritja e pagave, çmimet e mirëmbajtjes operative duhet të vlerësohet si shumë pozitive një ngritje e lehtë e nivelit të shpenzimeve krahasu me periudhën e vitit të kaluar. Do të ishte krejt normale që të regjistrohej një rritje e kësajë kategorie të shpenzimeve së paku deri 5% mbi shpenzimet e të njetës periudhë të vitit të kaluar. Kur jemi këtu duhet të pranojmë se kemi patur një racionalizim dhe zvoglim të shpenzimeve operative.

NJOU - PRISHTINA	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	3,253,649	3,102,410	3,002,506	3,174,617
BIZNESET	1,262,677	1,056,357	1,259,207	1,014,843
INSTITUCIONET	1,008,195	885,504	990,670	813,285
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	5,524,522	5,044,271	5,252,383	5,002,746
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	2,769,055	3,032,037	2,740,598	2,958,681
BIZNESET	1,159,951	1,074,580	1,218,343	1,067,784
INSTITUCIONET	990,615	992,055	983,301	832,804
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	4,919,621	5,098,672	4,942,242	4,859,269
TË ARDHURAT TJERA	0	-68,894	975,024	1,306,256
TOTALI I TË ARDHURAVE	4,919,621	5,029,778	5,917,265	6,108,069
SHPENZIMET	3,118,835	3,694,581	3,615,122	3,623,337
SHPENZIMET PER FABRIKEN NE SHKABAJ-VONESA-SHTRABAK				207,466
SHPENZIMET E INTERESIT-KREDIA				217,465
SHPENZIMET				4,048,268
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA	1,800,786	1,335,196	2,302,144	2,059,803

Njësia Fushë Kosovë

- **Të ardhurat e faturuara**, të gjitha kategoritë kemi patur një ngritje në planifikim, krahasu me realizimin e vitit paraprak perveq te amvisëritë ku kemi një zvoglim të planit apo rritje te realizimit ne vlera te konsiderueshme. Objektivat e planit nuk u realizuan dhe u tejkaluan te kategoria e bizneseve të vogla, dhe institucioneve kurse te kategorita e amviserise kemi patur ngritje të konsideruar të shkallës së faturimit krahasuar me të njetën periudhë të vitit të kaluar, por ngecje apo mospermbushje të planit për vitin raportues.
- **Të ardhurat e inkasuara**, per të gjitha kategoritë e konsumatorëve janë më të uleta se sa perudha krahasuese apo viti i kaluar perveq tek kategoria e amviserise. Në total të ardhurat e inkasuara janë të peraferta me planin dhe periudha e njejte e vitit paraprak,. Shkalla e inkasimit apo të ardhurat e inkasuara per Fushë Kosovë ishin 87% është nivel ky i dëshiruar. Realizimi i inkasimit në institucione është i kenaqshem. Kjo % konsiderojmë se është e permiresuar. Po shpresomë se pjesa e dytë e vitit 2019 do të jetë i mirë në realizim për shkakun e borxheve të cilat i kanë institucionet.
- **Shpenzimet** janë 2% nen planin, bazuar në rritjen e çmimeve të sherbimeve të tjera si Rryma, nafta, rritja e pagave, çmimet e mirëmbajtjes operative duhet të vlerësohet si shumë pozitive një ngritje e lehtë e nivelit të shpenzimeve krahasu me periudhën e vitit të kaluar. Kur jemi këtu duhet të pranojmë se kemi patur një racionalizim dhe zvoglim të shpenzimeve operative.

FUSHË KOSOVË	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	320,417	391,456	372,564	452,934
BIZNESET	48,697	63,810	85,865	65,281
INSTITUCIONET	19,068	20,314	32,910	19,075
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	388,182	475,580	491,340	537,290
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	273,294	348,354	340,014	383,821
BIZNESET	43,111	61,857	80,065	52,271
INSTITUCIONET	18,735	16,680	32,664	28,687
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	335,140	426,891	452,743	464,779
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	335,140	426,891	452,743	464,779
SHPENZIMET	175,766	81,810	102,262	100,197
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		345,082		364,583

Njësia e Graçanicës

- **Të ardhurat e faturuara**, kemi patur një ngritje të planifikimit, Planifikimi i të ardhurave të faturuara të njësia e Graçanicës është permirsuar dukshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Plani do të duhej të rritej por në këte rast mendojmë se ka qenë një plan tejte ambicioz dhe vështirë i arritshëm.
- **Të ardhurat e inkasuara**, shkalla e realizimit të të ardhurave është e mirë te kategoria e bizneseve të vogla dhe tek bizneset e mëdha, kurse me pak e mire është tek rezultatet te kategoria kryesore amvisëritë dhe institucionet. Kjo njesi ka një % nën mesataren e kompanisë dhe nga ky aspekt. Kur jemi te kjo analizë e të ardhurave të inkasuara, duhet të shprehemi kritik se realizimi jo ma i ulët i vitit 2018 se sa per vitin 2019 te kategoria e amvisërisë dhe te bizneset e mëdha, është në rregull sepse nuk kemi renje por as rritje sillet aty njesoj sikur ne vitin paraprak.
- **Shpenzimet**: janë zvogeluar dukshem mbi planin kjo nuk është mirë kur kemi para syshë ata faktor që i kemi permend gjatë analizes që iu kemi bë shpenzimeve të pergjithëshme në Kompani. Kur jemi te kjo njësi mund të themi se nga aspekti i mbulueshmërisë së shpenzimeve me gjenerim të të ardhurave mund të jemi të pa kënaqur, edhe pse shkalla e humbjeve apo ujit të pafaturuar është shumë e lartë dhe koncentrimi i pergjegjësve dhe stafit të kesajë njësie duhet të jetë i orjentuar në dedektimin e humbjeve të larta teknike dhe komerciale që i kemi në zonën që e mbulon kjo njësi.

GRAÇANICA	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	123,028	113,237	128,296	116,584
BIZNESET	64,676	47,410	50,643	55,956
INSTITUCIONET	17,892	10,575	12,130	8,781
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	205,596	171,223	191,070	181,322
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	104,466	141,335	116,792	130,617
BIZNESET	59,980	60,647	47,904	30,443
INSTITUCIONET	17,580	19,049	12,040	6,065
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	182,026	221,031	176,735	167,125
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	182,026	221,031	176,735	167,125
SHPENZIMET	97,116	72,342	90,427	64,261
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		148,689		102,864

Njësia e Podujevës

- **Të ardhurat e faturuara**, kemi patur një ngritje të planifikimit, Planifikimi i të ardhurave të faturuara të njësia e Podujevës është permirsuar dukshëm në krahasim me të njejtën periudhë të vitit të kaluar. Plani do të duhej të rritej por në kete rast mendojmë se ka qenë një plan tejte ambicioz dhe vështirë i arritshëm.
- **Të ardhurat e inkasuara**, shkalla e realizimit të të ardhurave është e mirë te kategoria e bizneseve të vogla dhe tek bizneset e mëdha, kurse jo me e mire është tek rezultatet te kategoria kryesore amvisëritë dhe institucionet. Kjo njesi ka një % nën mesataren e kompanisë dhe nga ky aspekt mund të shprehim pakënaqësi.
- **Shpenzimet**: janë ulur mbi planin kjo nuk është mirë kur kemi para syshë ata faktor që i kemi përmend gjatë analizës që iu kemi bërë shpenzimeve të përgjithëshme në Kompani. Kur jemi te kjo njësi mund të themi se nga aspekti i mbulueshmërisë së shpenzimeve me gjenerim të të ardhurave mund të jemi të pa kënaqur, edhe pse shkalla e humbjeve apo ujit të pafaturuar është shumë e lartë dhe koncentrimi i përgjegjësve dhe stafit të kësajë njësie duhet të jetë i orjentuar në dedektimin e humbjeve të larta teknike dhe komerciale që i kemi në zonën që e mbulon kjo njësi.

PODUJEVË	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	316,236	292,028	318,380	301,425
BIZNESET	60,803	52,445	68,899	51,118
INSTITUCIONET	43,021	28,016	35,663	24,650
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	420,060	372,489	422,942	377,193
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	266,508	203,573	252,120	218,410
BIZNESET	53,473	45,740	63,612	40,188
INSTITUCIONET	42,270	18,731	35,397	18,689
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	362,251	268,046	351,129	277,287
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	362,251	268,046	351,129	277,287
SHPENZIMET	308,565	142,057	177,571	139,954
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		125,989		137,333

Njësia e Kastriotit

- **Të ardhurat e faturuara**, Është karakteristikë e kësajë njësie ku kemi regjistru një planifikim të mirë të të ardhurave të faturuara, ka patur rezultate të prekshme dhe shumë të mira. Realizim i planit që kishim në krahasim me vitin paraprak te kategoria e Amvisërisë, gjendja me pak e mirë na ka dalë te bizneset e mëdha dhe te institucionet ku është arritë një rezultat i ulët. Kategoria e amviserise ka pasur ngritje te konsiderueshme nga planifikimi.
- **Të ardhurat e inkasuara**, tregojnë nivel të mirë, treguesit kryesor të performancës financiare tregojnë se diçka pozitive është duke ndodh dhe kemi mbi 7% realizim i tejkaluar sidomos ne kategorie e amviserise. Perqindja e realizimit krahasuar me planin është shumë e mirë. Të ardhurat e realizuara por edhe shpenzimet janë pak më të larta se planifikimi. Kjo tregon me se miri kur behet nje prerje ne mes ketij viti dhe vitit te kaluar te periudhes se njejte sepse kemi faturim edhe inkasim me te larte se sa ne vitin paraprak
- **Shpenzimet**, janë në nivel me planifikimin apo edhe ulje ne krahasim me planin dhe periudhen e njejte te vitit paraprak.

OBILIQ	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	256,191	292,848	282,663	297,467
BIZNESET	30,522	31,888	65,717	33,035
INSTITUCIONET	14,491	17,975	21,863	16,430
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	301,205	342,710	370,242	346,933
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	217,162	227,352	229,068	245,825
BIZNESET	27,384	28,820	58,152	28,012
INSTITUCIONET	14,238	7,162	21,700	11,266
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	258,784	263,334	308,919	285,104
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	258,784	263,334	308,919	285,104
SHPENZIMET	382,696	102,895	128,619	101,417
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		160,439		183,687

Njësia Shtime

- **Të ardhurat e faturuara**, po i shikuar në vlera planifikuese, duket se kemi një plan real të të ardhurave, edhe realizimi nuk është edhe aq keq edhe pse përqindja e realizimit të të ardhurave nëpër kategori është e ulët. Plani i faturimit duket se është jo real, mundësitë janë bukur ma të larta dhe nga kjo del se edhe faturimi është dashtë të jetë ma i lartë se sa ky i paraqituri nga njësia.
- **Të ardhurat e inkasuara**, këtu kemi një rezultat ne ulje, derisa kemi një planifikim të të ardhurave të faturuara ku mbetet me shume per te arritur, diçka shumë normale paraqitet gjendja me planin e të ardhurave të inkasuara. Po shikuar në bazë të përqindjeve të realizimit del se njësia e Shtimes ka regjistru rezultate te uleta, të gjithë treguesit në të gjitha kategoritë nuk kanë tejkaluar planin edhe ate në përqindje të larta. Çka mund të themi se plani i inksimit ka qenë jo real dhe nuk mund tui besojmë përqindjeve të cilat me të vertetë tregojnë mos sukses.
- **Rritja e shpenzimeve**. vazhdohet me rritjen e nivelit të humbjeve të ujit, rritjen e borxhit të konsumatorëve, rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve tjera operative. Kjo njësi mezi që arrin të mbuloj shpenzimet e veta operative deri në 90%, kjo është pak dhe kerkohet mobilizim i të gjithëve për të ngritur shkallën e inkasimit por edhe zvoglimin e shpenzimeve. Me shume kemi shpenzimet se sa të ardhurat, kjo dukuri duhet të marrë orientimin e duhur, nuk ka mundësi të mbahet një ritëm i tillë i realizimit të të ardhurave kur për një plan dhe realizim shumë ma të mirë i kemi kushtet ideale në këtë njësi.

SHTIME	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	106,699	99,185	100,287	100,578
BIZNESET	16,998	13,821	12,732	15,103
INSTITUCIONET	24,633	23,544	20,358	15,840
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	148,330	136,551	133,378	131,521
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	90,437	66,690	76,269	71,223
BIZNESET	14,714	12,228	11,491	8,866
INSTITUCIONET	24,203	20,987	20,206	16,301
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	129,353	9,905	107,966	96,390
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	129,353	99,905	107,966	96,390
SHPENZIMET	169,963	138,632	173,290	126,246
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		(38,727)		(29,856)

Njësia e Lipjanit

- **Të ardhurat e faturuara**, inkurajon fakti se kemi rënie të faturimit se sa e njeta periudhë e vitit paraprak te kategoria e amviserisë. Kjo tregon se njësia në Lipjan sa i perket faturimit po ecën mirë por duhet te rritet faturimi duke marre parasysh ujin qe e prodhon. Po analizuam secilën kategori veq e veq do të shohim se tek të gjitha kategoritë kemi pasur një rritje të planit të faturimit te biznest e vogla ku kemi një rritje me te larte të planit. Ky plan nuk është realizuar në tersi për secilën nga kategoritë e konsumatorëve por gëzon fakti se në total kemi realizim të planit mbi 2%.
- **Të ardhurat e inkasuara**, gati të gjitha kategoritë kanë i janë ofruar realizimit të planit , buizneseve të mëdha tek të cilat kemi permiresim edhe në nivel të kompanisë si dhe në të gjitha njësitë operative. Krahasu me periudhën e njetë të vitit praprak del se kemi pas një rritje të inkasimit krahasuar me periudhen e njetë të një viti ma parë. 80% është shkalla e inkasimit dhe renie krahasuar me vitin paraprak ky nivel inkasimi konsiderojmë se duhet te punohet me shume, sidomos kur bëjmë krahasim me të njetën periudhë të vitit paraprak.
- **Shpenzimet**, është ky një zë i bilancit që nuk ka tejkalu parashikimet edhe në aspektin e të ardhurave por edhe me shpenzime. Sa iu perket shpenzimeve jemi me plan shume me pak por jemi te barabarte me periudhen e njetë te vitit paraprak. Kur kemi parasyshë sasinë e borgjeve që konsumatorët i kanë ndaj kësajë njësie si dhe ujin e pafaturuar që po i humbet do të konstatojmë dhe të japim detyrë per koordinatorin që të bëjë çdo gjë që ka mundësi dhe së paku të mbuloj shpenzimet operative dhe pagat për punëtorët e vet.

LIPJAN	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	193,112	224,586	227,636	232,726
BIZNESET	62,184	72,710	67,863	76,387
INSTITUCIONET	29,241	33,999	39,054	33,055
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	284,537	331,296	334,553	342,167
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	163,932	159,447	183,924	168,925
BIZNESET	56,933	70,575	61,432	74,167
INSTITUCIONET	28,730	34,850	38,762	32,562
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	249,595	264,871	284,118	275,654
TË ARDHURAT TJERA				
TOTALI I TË ARDHURAVE	249,595	264,871	284,118	275,654
SHPENZIMET	353,036	283,794	354,742	283,573
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		(18,923)		(7,919)

Njësia në Drenas

- **Të ardhurat e faturuara**, një plan real i të ardhurave të faturuara, ndoshta të amvisëritë kemi planifikuar sakt por mund të konstatohet se në përgjithësi të kjo njësi kemi pasur një plan real të faturimit, ka qenë shumë i mirë realizimi i këtij plani ku bizneset e mëdha dhe institucionet kanë shkruar mirë në realizim. Me e rëndësishme është fakti se të kategoria e amvisërisë kemi realizim të planit me % të lartë. Totali i të ardhurave të faturuara është me mirë se nga viti krahasues, kurse plani i realizimit ishte tejkaluar.
- **Të ardhurat e inkasuara**, të gjitha kategoritë kanë pasur një stabilitet në inkasim, ishte më keq se e njëta periudhë e vitit të kaluar por pritet që rezultatet të përmirshohen në vazhdimin e vitit. Kjo ulje ka shkaktuar edhe mos furnizimin me ujë biznesin e madh e në Feronikel e që ka shkaktuar rënie në faturim ashtu edhe në inkasim. Një vlerësim i përgjithshëm është se kjo njësi ka hapa pozitiv drejt realizimit të objektivit të paraparë. Kur jemi të plani i të ardhurave dhe inksimi sa i përket njësive janë bërë dhe po bëhen përpjekje për të patur një plan sa më afër realitetit dhe asaj që në fakt duhet të jetë në këtë njësi.
- **Shpenzimet**, është ky një zë i bilancit që ka tejkalu parashikimet edhe në aspektin e të ardhurave por edhe me shpenzime. Sa iu përket shpenzimeve jemi mbi plan . Duhet të ketë kujdes që të krijoj plan të tillë duke rritur të ardhurat, inkasimin edhe më të mirë të tyre dhe njëkohësisht të planifikoj shpenzime më të ulëta ose së paku të barabarta me inksimin, përndryshe një ngjarje e tillë ku kemi tejkalim të shpenzimeve edhe mbi planin por edhe mbi të hyrat tregon se njësia ende po vazhdon të varet nga qendra apo nuk po arrijnë ta mbajë vetëvehten me të hyrat që po krijojnë. Kur kemi parasyshë sasinë e borgjeve që konsumatorët i kanë ndaj kësaj njësie si dhe ujin e pafaturuar që po i humbet do të konstatojmë dhe të japim detyrë që të bëjë çdo gjë që ka mundësi dhe së paku të mbulojë shpenzimet operative dhe pagat për punëtorët e vet.

DRENAS	Janar- Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TË ARDHURAT E FATURUARA				
AMVISËRIT	137,178	147,709	152,028	151,869
BIZNESET	35,119	36,090	35,520	38,399
INSTITUCIONET	28,054	23,876	21,979	24,439
TOTALI I TË ARDHURAVE TË FATURUARA	200,351	207,675	209,528	214,707
TË ARDHURAT E INKASUARA				
AMVISËRIT	115,586	104,828	118,859	140,019
BIZNESET	30,807	38,106	33,323	36,725
INSTITUCIONET	27,564	11,499	21,815	23,499
TOTALI I TË ARDHURAVE TË INKASUARA	173,957	154,433	173,998	200,243
TË ARDHURAT TJERA		68,894		57,456
TOTALI I TË ARDHURAVE	173,957	223,327	173,998	257,699
SHPENZIMET	360,428	176,511	220,639	290,867
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA		46,816		-33,168

TOTALI I KUR "PRISHTINA" SH.A	Janar - Qershor 2018		Janar - Qershor 2019	
	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Planifikuar 2019	Realizuar 2019
TOTALI I TE ARDHURAVE	6,610,726	6,728,289	7,772,874	7,724,455
TOTALI I SHPENZIMEVE REGJIONALE	4,966,405	4,692,621	4,862,672	5,154,782
TEPRICA OPERATIVE-HUMBJA	1,644,321	2,035,667	2,910,202	2,569,674

Shpenzimet totale ne kuader te kompanise sipas kategorive

SHPENZIMET NE TOTAL	Janar - Qershor- 2018		Janar - Qershor- 2019	
	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
VLERA FURNIZUESE E MATERIALIT	327,079	327,276	331,663	343,820
SHPENZIMET E ENERGJISE	1,474,367	1,099,864	1,120,055	1,102,218
SHPENZIMET E KARBURANTEVE	76,245	52,037	47,309	57,108
SHPENZIMET E PËRSONELIT	2,417,609	2,476,818	2,699,344	2,723,361
SHPENZIMET MATERIALE	275,174	402,013	307,448	155,796
SHERBIMET E JASHTME KONTRAKTUESE	321,448	282,896	307,025	712,573
SHPENZIMET E REKREACIONIT, SPORTIT, KULTURËS DHE NDIHMAVE SOLIDARE	-	4,838	3,284	1,815
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES DHE RIPARIMIT	41,033	40,918	38,517	56,264
TE DALURAT FINANCIARE DHE TRANSFERI I REZULTATIT FINANCIAR	33,451	5,962	8,026	1,827
GJITHSEJTË SHPENZIMET OPERATIVE	4,966,406	4,692,622	4,862,672	5,154,782

Testet e planifikuara-analizat kimike dhe bakteriologjike nga laboratorit janë realizu mbi planinifikimin. Nderprejet e ujit per konsumatorë kanë qene te vogla, me perjashtim te rasteve ku ka pasur ndonje problem teknik, derisa është rregulluar nga ana e punetoreve te KRU Prishtina sh.a. , edhe pse qellimi dhe objektivi ynë ishte dhe mbetet ne permbushjen e rregullave te ARRU-it 24 ore ujë per konsumatorët

Departamenti Ligjorë

Departamenti Ligjor ka procesuar të gjitha kërkesat të cilat i janë adresuar këtij Departamenti duke u kujdesur për respektim të afateve ligjore për të gjitha shkresat dhe parashtresat e pranuar. Në vijim paraqesim të dhënat e shprehura në statistika për të gjitha punët e kryera gjatë periudhës Janar-Qershor 2019.

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 15 seanca për kontest borxhi, të gjitha kanë përfunduar pasi konsumtoret e paditur me heret në Gjykatë kanë kryer obligimin e tyre ndaj KRU "Prishtina" sh.a.

Gjatë periudhës raportuese janë bërë 8 (tetë) terheqje të Propozim Permbarimit nga Gjykata për 8 (tetë) konsumator të paditur të cilët kanë kryer obligimin e borxhit si dhe kanë paguar taksen gjyqësore.

Gjatë muajit Janar janë dorëzuar dy Pergjigje në Padi ndaj dy Paditësve të cilët kanë paditur për kontest borxhi – mbi-faturim.

Me datë 22.01.2019 është mbajtur një seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – seanca vazhdon ndaj Paditësit i cili ka kërkuar kompensim dëmi për dëmin e shkaktuar nga gypat e Ujësjiellit.

Me datë 28.01.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë kundër të fajësuarit i cili ka bërë kyçje ilegale në rrjetin e Ujësjiellit. Faji është pranuar nga i pandehuri, rasti ka përfunduar përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Me datë 11.01.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – Departamenti për Kundërvajtje, lidhur me iniciimin e procedurës kundërvajtëse nga Inspektoret Komunal të KK Obiliq ndaj punëtorëve të KRU Prishtina për dëmtimet e shkaktuara në trotuar gjatë punimeve.

Me datë 14.01.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – Divizioni Penal, lidhur me kyçje ilegale në rrjetin e Ujësjiellit.

Me datë 05.02.2019 është dorëzuar në Gjykatë një Pergjigje në Padi, lënda me numër A.nr.486/16 kundër Paditësit për mbi-faturim.

Me datë 06.02.2019 është mbajtur seancë gjyqësore me Paditësin për Borxh dhe procedura ka përfunduar pasi paditësi i ka kryer të gjitha obligimet ndaj KRUP-së .

Me datë 06.02.2019 është mbajtur seancë gjyqësore me Paditësin, lënda kontestuese Kompensim Dëmi, e njëjta është shtyer në afat të pa-caktuar pasi pala paditëse ka propozuar ekspertizë në vendin e ngjarjes.

Me datë 12.02.2019 është bërë tërheqja e Propozimit për Përmbarim nga Përmbaruesi Privat pasi që debitori ka paguar shumën prej 881.17€ si dhe taksen 45.00€ P.NR.82/16.

Me dt 25.02.2019 është mbajtur seancë gjyqësore për Kontest Pune, C.nr.1184/92 seanca vazhdon.

Me datë 22.02.2019 dhe 25.02.2019 janë dorëzuar të Përmbaruesit Privat 7 (shtatë) lëndë për borxhin total në vlerë prej 11,808.93 €.

Brenda afatit ligjore është bërë Përgjigjja në Padi ndaj Paditësit Naser Rusinofci, lënda kontestuese Kompensim Dëmi.

Gjithashtu i është ushtruar Përgjigjja në Padi ndaj Paditësës Minire Maloku, lënda kontestuese Faturimi Paushall.

Poashtu është ushtruar Përgjigjja në Padi për Paditësin Ilir Asllani ku objekt kontesti ka qënë faturimi.

Po ashtu është bere Ankesë ne Gjykatën e Apelit për Debitorin Xhevat Sadiku me P.nr.312.2017 lënda kontestuese për borxh.

Me datë 06.02.2019 janë dorëzuar në Gjykatën Themelore Prishtinë 3 Parashtresa për Tërheqje ë lëndeve pasi debitorët kanë kryer të gjitha obligimet ndaj KRUP-së, si dhe është paguar vlera e taksave 50.00€.

Me datë 07.03.2019 është dorëzuar një përgjigje në Prapësim tek Permbaruesi Privat ndaj një debitori i cili e ka kontestuar obligimin e tij ndaj shërbimeve të ujësjellësit.

Me datë 08.03.2019 është terhequr një Propozim për Përmbarim pasi debitori ka paguar shumën prej 100.00 € si dhe taksen gjyqësore në vlerë prej 45.00 €.

Me datë 11.03.2019 është mbajtur një seancë për kontestin Kompensim Dëmi. Rasti është në procedurë.

Me datë 20.03.2019 është terhequr një Propozim për Përmbarim pasi që debitori ka paguar shumën prej 503.14 si dhe taksen gjyqësore në vlerë prej 46.20 €.

Me datë 29.03.2019 është dorëzuar një përgjigje në prapësim ndaj një debitori i cili e konteston borxhin/obligimin ndaj KRU "Prishtina" sh..a

Brenda afatit ligjor janë ushtruar 2 (dy) ankesa në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Podujevë ndaj 2 (dy) lëndëve për të cilat është ushtruar propozimi për Permbarim.

Brenda afatit ligjor është kthyer Përgjigjja në Padi për padinë e ushtruar në Gjykatën Themelore Prishtinë, kontesti borxh.

Me datë 01.04.2019 janë dorëzuar 3 ankesa në Gjykatën e Apelit Prishtinë për kontest borxhi për debitorët: Milaim A. Mekolli P.NR.86/17, vlera e borxhit 951.86€, Skender Islami P.nr.119/17, vlera e borxhit 896.70€ dhe Osman Hamiti P.nr.65/17, vlera e borxhit 1,102.05€ - pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë pjesërisht ka pranuar kundërshtimin e Kreditorit ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar si të parashkruar. Ne kemi ushtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit dhe presim Aktvendimin.

Me datë 01.04.2019 është dorëzuar një ankesë në Gjykatën e Apelit Prishtinë - Divizioni për Kundervajtje pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar KRU "Prishtina" sh.a., në vlerë prej 2,000.00€. Ky dënim ka ardhur si pasojë që punëtorët e KRU "Prishtina" sh.a., Njësia në Obiliq kanë dëmtuar trotuarin, pemët afër trotuarit gjatë punimeve si dhe nuk e kanë kthyer në gjendjen e mëparshme edhe pse i është kërkuar nga Inspektorati Komunal në Obiliq. Po ashtu, të njëjtit punëtor nuk janë pajisur paraprakisht me leje përkatëse nga kjo komunë. Presim Aktvendimin nga Gjykata e Apelit.

Me datë 02.04.2019 është dorëzuar një Ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë për kontest borxhi, lënda me numër P.nr.27/18 kunder debitorit, vlera e borxhit 991.60€ pasi që Gjykata Themelore Prishtinë ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit i cili ishte thirrur në parashkrim. Presim Aktvendimin nga Gjykata e Apelit.

Me datë 03.04.2019 është mbajtur një seancë në Gjykatën Themelore Prishtinë - Dega Graqanicë për Kompenzim Dëmi, vlera e kontestit sipas Padisë është 3,000.00€. Paditësi ka kërkuar kompenzim të dëmit sepse sipas pretendimeve të tij ka marrë lëndime trupore në pusetën e KRU "Prishtina" sh.a., dhe sipas pretendimeve të paditësit puseta ka qënë e hapur, seanca vazhdon me datë 12.06.2019.

Me datë 03.04.2019 është mbajtur seancë gjyqësor për kontest borxhi, vlera e borxhit 822.26 €, lënda është përfunduar me tërheqje të padisë pasi që konsumatori e ka kryer borxhin.

Me datë 03.04.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – Divizioni Penal ku i pandehuri e ka pranuar fajsinë për kyçje ilegale në rrjetin e ujësjellësit. Në bazë të Kallëzimit Penal dhe sipas Aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prishtinë akuzohet për veprën penale Lidhja e Paautorizuar në Shërbime nga neni 321 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 04.04.2019 është mbajtur seancë me ish punëtorin e KRUP-së Nexhmi Shala, vlera e kontestit sipas ekspertizes është 42,124.72€ i cili ka kërkuar kompenzimin e pagave nga viti 1992-1999. Kjo lëndë identifikohet me C.nr.1184/92, seanca është shtyer për datë 16.04.2019, poashtu edhe më këtë datë është dhënë fjala perfundimtare nga palët ndergjyqëse dhe Gjykata i ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Me datë 08.04.2019 është mbajtur seancë me Paditesin, lënda numer C.nr.1120/14 i cili me Padi ka kërkuar që t'i shlyhet faturimi fiktiv të cilin sipas pretendimeve të tij nuk e ka hargjuar. Presim Aktvendimin nga Gjykata Themelore.

Me datë 10.04.2019 është tërhequr një Propozim Permbarim pasi që debitori ka paguar shumën prej 100€ si dhe 46.02€ taksen fillestare, P.nr.232/19 si dhe për pjesën tjetër të borxhit ka hyrë në ri-programim.

Me datë 12.04.2019 është tërhequr një Propozim për Permbarim nga Permbaruesi Privat pasi që debitori pagoj 100€ si dhe 44.84€ taksen fillestare, P.nr.233/19 si dhe ka riprogramuar borxhin.

Me datë 18.04.2019 janë tërhequr 2 Propozime për Permbarim nga Gjykata pasi që debitori EDA.NR.4303/11 Riprogramoi borxhin si dhe ka paguar shumën prej 20€, taksen gjyqësore, ndersa debitori EDA.NR.3557/11, ri-programoj borxhin si dhe pagoj taksen gjyqësore 20€.

Me datë 18.04.2019 është mbajtur një seancë me ish punëtorin e KRU "Prishtina" sh.a. i cili ka paditur KRUP-në për Shperblim Jubilar, presim Aktvendim nga Gjykata Themelore.

Me datë 23.04.2019 janë dorëzuar në Gjykatë 2 konkluzione për precizim të adresave të debitoreve pasi që Gjykata ka kërkuar nga KRU "Prishtina" sh.a., lënda me numër PPP.765/18, 1217/18.

Me datë 24.04.2019 është mbajtur seancë gjyqësore, lënda A.nr.1297/17, palë e paditur është KRU "Prishtina", objekt kontesti është Anulim i Vendimit për shkak të faturimit jo të drejtë.

Me datë 30.04.2019 është tërhequr një Propozim për Permbarim nga Permbaruesi Privat pasi që debitori pagoj shumën prej 841.60€ si dhe 46.02€ taksen fillestare, lënda me numër P.nr.235/19.

Në afatin Ligjor është bërë Përgjigja e Padis për Paditësin nga Prishtina, ku objekt kontesti është Shpërblimi Jubilar, vlera e kontestit është 2,547.76 €.

Gjatë muajit Maj Zyra Ligjore ka proceduar të Permbaruesit Privat gjithsejt 181 lëndë për konsumatorët borxhlinj me vlerë totale të borxhit: 273,503.94 €.

Gjatë muajit Maj është bërë pagesa në shumën prej 2,273.83 € dhe taksa fillestare 191.16 € nga Konsumatorët e paditur në këtë muaj.

Me datë 03.05.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – Divizioni Penal, kontesti: Kycje e pa-autorizuar në shërbimet e ujësjellësit dhe në këtë rast kemi pranuar Aktgjykimin ku i pandehuri është shpallur fajtor dhe dënim me gjobë prej 150.00 €.

Me datë 07.05.2019 është mbajtur një seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe KRU “Prishtina” sh.a. objekt kontesti Shlyerje e borxhit. Kjo lëndë ka qënë e vitit 2015, konsumatori i ka kryer të gjitha obligimet dhe kjo lëndë është përfunduar.

Me datë 08.05.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë ku objekt kontesti ka qënë borxhi, kjo lëndë ka përfunduar pasi që u arrit ujdia gjyqësore ku debitori pagoj shumën prej 155.00 € si dhe taksen gjyqësore 10.00 €.

Me datë 08.05.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë me kontestin për Shpërblim Jubilar ndaj një ish-punëtori të KRU “Prishtina” sh.a., vlera e padisë 2,547.76 €. Kemi pranuar Aktgjykimin nga Gjykata Themelore në të cilin Gjykata i ka aprovuar pjesërisht kërkespadinë e paditësit. Brenda afatit ligjor do të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit.

Me datë 15.05.2019 është mbajtur seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë, KRU “Prishtina” sh.a., ka qënë palë e paditur për kontest faturim jo i drejtë. Jemi në pritje të Aktvendimit.

Me datë 27.05.2019 është ushtruar Prapësim për lëndën C.nr.326/19 me vlerë të borxhit prej 2,965.32 €. Kjo lëndë ka të bëjë me shpërblim jubilar ndaj një ish-punëtori të KRU “Prishtina” sh.a. Gjykata Themelore i ka aprovuar kërkesën në tërësi dhe kjo lëndë është në procedurë.

Gjatë muajit Qershor Departamenti Ligjor ka proceduar të Permbaruesit Privat gjithsejt 69 lëndë për konsumatorët borxhlinj me vlerë totale të borxhit: 113,238.86 €.

Gjatë muajit Qershor nga lëndët e derguara te Permbaruesit Privat është bërë pagesa në shumën prej 6,823.95 € dhe taksa fillestare 434.60 € nga Konsumatorët e paditur në këtë muaj.

Gjatë muajit Qershor janë dorëzuar pesë Pergjigje ndaj Prapësimeve të konsumatorëve për pesë lëndë të derguara te Permbaruesit Privat.

Me datë 12.06.2019 është mbajtur një seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Graçanicë për Kompensim Dëmi, vazhdon procedura gjyqësore për këtë lëndë.

Gjatë muajit Qershor është ushtruar një Ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit me aprovim të pjesërishtëm për kërkesëpadinë e ish-punëtorit të Kompanisë për shpërblim jubilar.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të Zyres Ligjore janë kryer edhe punë të ndryshme administrative sipas kërkesës si: Caktimi në Komisione, mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me Permbaruesit Privat në lidhje me debitorët, sqarimi i konsumatorëve të cilët kanë ardhur për konsulta në Departamentin Ligjor për çështje të ndryshme si dhe përgjigja në shkresa të ndryshme.

Raporti I Prokurimit

Qëllimi i këtij raporti gjashtëmuor të punës (TM1 & TM 2) është që të prezantohet aktiviteti i Departamentit të Prokurimit, ne kuader të KRU "PRISHTINA" sh.a, gjatë periudhës 1 janar deri me 30 qershor të vitit 2019.

Gjate kesaj periudhe, është vazhduar me pranimin e kërkesave nga departamentet dhe njesite e KRU "PRISHTINA" sh.a. si dhe është bërë procesimi i tyre, përmes procedurave të hapura apo edhe procedurave të tjera të tenderimit, ne perputhje me Ligjin per Prokurim Publik ne Republiken e Kosoves.

Raporti paraqet shkallën e realizimit të kërkesave sipas numrit dhe vlerës së tyre të dorezuara. Raporti permbane te dhena shtese rreth performancës së departamentit, qoftë në raport me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, Agjensionin Anti-Korrupsion apo edhe trupat e tjera rregullatore dhe mbikqyrëse të prokurimit ne Republikën e Kosovës.

Ne pika te shkurtera, raporti poashtu paraqet edhe sfidat dhe vonesat gjatë ekzekutimit të detyrave te parapara.

PERFORMANCA

Te dhenat e meposhtme mund t'i sherbejne lexuesit të raportit për të vlerësuar me lehtësi aktivitetet e procesuara permes departamentit te prokurimit ne kuader te KRU PRISHTINA sh.a, pergjate periudhës raportuese.

Parametri kryesor i perdorur per te prezantuar performancen e departamentit te prokurimit ka te beje me raportin në mes të numrit të kërkesave të planifikuara dhe atyre të dorezuara (pranuara) si dhe numrit të kërkesave te realizuara, perfshire vlerat e tyre financiare.

I. RAPORTIN NË MES TË KËRKESAVE TË PLANIFIKUARA DHE TE DOREZUARA SIPAS NUMRIT DHE VLERAVE TE TYRE TE PARASHIKUARA

Nr	Pershkrimi	Sipas Numrit	(%)	Sipas Vleres financiare (€)	(%)
1	Kërkesa <u>te planifikuara</u> per periudhen 01 janar -30 qershor 2019	47	100	2,773,000.00	100
2	Kërkesa <u>te dorezuara</u> per periudhen 01 janar-30 qershor 2019	30	63.83	1,920,100.00	69.24%
3	Kërkesa <u>te pa-dorezuara</u> per periudhen 01 janar-30 qershor 2019	17	36.17	852,900.00	30.76

II. RAPORTIN NË MES TË NUMRIT TE KËRKESAVE TE DOREZUARA DHE REALIZUARA SIPAS VLERAVE TE PARASHIKUARA

Nr	Pershkrimi	Sipas Numrit	(%)	Sipas Vleres financiare (€)	(%)
1	Kërkesa <u>te dorezuara</u> per periudhen 01 janar -30 qershor 2019	30	100	1,920,100.00	100
2	Kërkesa <u>te realizuara</u> per periudhen 01 janar-30 qershor 2019	20	66.66	1,024,100.00	53.33
3.	Kërkesa <u>ne proces</u> per periudhen 01 janar-30 qershor 2019	10	33.33	896,000.00	46.66
4	Kërkesa <u>te anuluar</u> per periudhen 01 janar-30 qershor 2019	-	-	-	-

III. KERKESAT E DOREZUARA JAShte PLANIT TE PROKURIMIT JANAR-QERSHOR

Nr	Emërtimi i kërkesës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)
1	Furnizim me Rere-Zhavor	980.00
2	Furnizimi me Kamionetë_Mjetet e mbetura nga donacioni I KfW	35,000.00
3	Sigurimi i Automjeteve te KRUP sh.a., aneks kontrate deri 10% te kontrates.	6,000.00
4	Bilete Aeroplani Prishtine-Porto/Portugali	500.00
5	Nderrimi dhe Ndertimi I Rrjetit te KRUP sh.a. OBILIQ Pune shtese deri 10%	2,863.80
6	Ri-vleresimi Financiar e Teknik i Aseteve te KRUP sh.a.(RITENDER)	75,000.00
7	Furnizim me Bileta per BD_Berlin	990.00
8	Largimi I Mbetjeve nga Rrezimi I Ndertimeve pa Leje_Batllavë_VLERA 2,500 EURO RI-TENDER PAS SHKPUTJES SE KONTRATES ME "PRISHTINA ASFALT"	2,500.00
9	Pune shtese dhe te pa-parashikuara _Gypi 630 mm Shkabaj-F.Kosovë;	7,505.28
	GJITHSEJT	131,339.30

IV. KONTRATA TE NENSHKRUARA PER AKTIVITETET SIPAS PLANIT DHE ATYRE JASHT PLANIT

Nr	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Vlera e Kontrates se Nenshkruar (€)
1	Furnizimi me Kushineta per El.motor ne SP Milloshevi	500.00	329.99
2	Riparimi i gropave, kubezave dhe asfaltimi KK 3 VJEÇARE	105,000.00	68,490.00
3	Furnizim me Zhavor- zalle, per mbulimin e gropave dhe heqja e dheut dhe bartja e tij nga objekti i KRU-P deri ne deponi	65,000.00	48,450.00
4	Furnizimi me Goma per Kamione	2,000.00	720.00
5	Furnizimi me Naftë dhe Benzine_KK 3 vjecare me disa OE (450,000.00 €)	75,000.00	74,859.20
6	Furnizim me Pompa per Cisterna jasht Fuknsionit, (vlere e parashikuar e kerkeses 3,000.00 euro.)	5,000.00	2,650.00
7	Furnizimi me rafte dhe ormana metalik	2,200.00	1,770.00
8	Furnizim me material elektrik KK 2 vjeçare	50,000.00	50,000.00
9	Sigurimi Shendetsor I Personelit te KRUP sh.a. _v.2019(KompanA 50%)	150,000.00	134,316.00
10	Furnizim me pjese rezerve te ujit te profilave deri Ø90mm KK 3 VJEÇARE	180,000.00	147,380.00
11	Sherbime te Udhetimeve Ajrore per KRU PRISHTINA sh.a, KK 2 vjeçare	30,000.00	30,000.00
12	Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim per Objektet e KRU	20,000.00	9,817.60
13	Servisimi dhe riparimi i elektromotorëve në stacionin e pompave në Batllavë të K.U.R. Prishtina, sh.a. (dy lloje servisimi dhe riparimi Lot 1. Furnizimi me kushineta Lot 2)KK 2 VJEÇARE	40,000.00	25,824.00
14	Furnizimi me inventar (mobilje per zyre, rafta per depo etj) + Furnizim e Montim I Sporteleve ne Arka KK 2 VJEÇARE	40,000.00	27,105.00
15	Furnizimi me paisje ndërrimi elektronike automatike- kartela elektronike	30,000.00	29,314.34
16	Rehabilitimi ndertimor - arkitektonik i objekteve ne KURP	54,800.00	42,296.30
17	Furnizimi me Detektore, Lloger, Permallog, Mikrofon Tokesor, Ultrasonic per detektim te rrjedhjeve (humbjeve) te Ujit	30,000.00	29,954.30
18	Mirembajtja e Paisjeve per detektim te Rrjedhjeve te Ujit si dhe mbulim te shpenzimeve per marrjen e informatave nga Llogeret	10,000.00	9,999.32

Nr	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Vlera e Kontrates se Nenshkruar (€)
19	Furnizimi me Goma (deponimi sezonal, Bateri, lubrifikante, antifrees, G12, Uje xhamash) +Pajisje Rezerve	55,600.00	55,600.00
20	Riparimi, harrnimi, vullkanizimi, kalibrimi dhe ballansimi i gomave dhe automjeteve dhe deponimi sezonal i gomave	4,000.00	4,000.00
21	Furnizim me Rere-Zhavor	980.00	960.00
22	Furnizimi me Kamionetë_Mjetet e mbetura nga donacioni I KfW	35,000.00	33,950.00
23	Sigurimi i Automjeteve te KRUP sh.a., aneks kontrate deri 10% te kontrates.	6,000.00	6,711.58
24	Bilete Aeroplani Prishtine-Porto/Portugali	500.00	451.00
25	Nderrimi dhe Ndertimi I Rrjetit te KRUP sh.a. OBILIQ_Pune shtese deri 10%	2,863.80	2,863.80
26	Ri-vleresimi Financiar e Teknik i Aseteve te KRUP sh.a.(RITENDER)	75,000.00	65,000.00
27	Furnizim me Bileta per BD_Berlin	990.00	960.00
28	Largimi I Mbetjeve nga Rrezimi I Ndertimeve pa Leje_Batlavë	2,500.00	2,049.50
29	Pune shtese dhe te pa-parashikuara _Gypi 630 mm Shkabaj-F.Kosovë	7,505.28	7,505.28
	GJITHSEJT	1,080,439.08	913,327.21

Nga raporti i mesiperm, shihet se deri ne daten raportuese jane procesuar te gjitha kerkesat e dorezuara, ne shkallen 100%, ku 20 nga gjithsejt 30 kerkesa, sa jane dorezuar ne departamentin e prokurimit, jane te realizuara, ndersa 10 kerkesa te tjera jane ne proces te realizimit.

V. RAPORTIN NË MES TË KËRKESAVE TË PROCESUARA DHE ANKESAVENE OSHP

Numri i kerkesave te procesuara	Numri i ankesave, verejtjeve, nderhyrjeve apo opinioneve	Numri i ankesave te pa-bazuara	Numri i ankesave te bazuara
30	3	2	1

Sa u perket ankesave ne OSHP, KRU PRISHTINA sh.a, ka pranuar 3/tri ankese permes OSHP, nga te cilat 2/dy kane jane hedhur poshte nga OSHP si te pa-bazuara (te refuzuara) ndersa 1/nje është kthyer ne ri-vleresim dhe e njejta është ende ne proces.

VI. LLOJET E KERKESAVE TE DOREZUARA

Ne tabelen e meposhtme prezantojmë një analizë te llojeve të kërkesave, te kategorizuara ne furnizime sherbime apo punime

	Vlera e parashikuar (€)	Vlera e realizuar (€)	Vlera ne Proces	Vlera te anuluar
Furnizime	1,223,300.00	610,300.00	613,000.00	-
Sherbime	341,800.00	308,800.00	33,000.00	-
Punime	355,000.00	105,000.00	250,000.00	-
GJITHSEJT	1,920,100.00	1,024,100.00	896,000.00	-



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.

PRISHTINA

SHPALOSJET E PASQYRAVE FINANCIARE 2019

POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Pasqyrat financiare për TM2 30.06.2019 paraqesin gjendjen reale të "KRU " Prishtina" SH.A.me seli në Prishtinë.

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të bashkëngjitura janë përgatitur në përputhje me SKK dhe SNK dhe Raportimit Financiar

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë raportuar në Euro, e cila është monedha funksionale e Kompanisë.

Bazat e përgatitjes

Hartimi dhe përpilimi i pasqyrave financiare është bërë duke u nisur nga parimi i vazhdimësisë së biznesit dhe janë përgatitur nën konventën e Kostos Historike dhe bazat e matjes janë shpjeguar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë. Janë në përdorim 6 module:

1. Moduli i faturimit,
2. Moduli i pagave dhe resurseve humane,
3. Moduli i aseteve,
4. Moduli i materialeve-financiar dhe material dhe
5. Moduli i depos-material të veçanta të pakos "Pronet" të cilat në mënyrëgjysmë të automatizuar janë të lidhura me modulin Libri kryesor-kontabiliteti.
6. Moduli i kontabilitetit

Mbajtja e evidencës kontabël përkatësisht e veprimeve të tjera financiare e përfaqësohet përmes moduleve rregullohet me Parime të ndryshme të brendshme, Rregullore, Rregulla, Udhëzime dhe Vendime.

Me këto rregullohen fusha të ndryshme të veprimtarisë së rregullt të Kompanisë Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" sh.a.

Transaksionet ne monedhë të huaj

Të gjitha llogarite bankare janë në monedhën Euro dhe po ashtu të gjitha transaksionet kryhen në monedhën e Euros.Nuk kemi transaksione në monedhë të huaj.

Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Kompanisë përbëjnë llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme dhe të tjera dhe kreditë e huamarrjes që mbartin interes. Instrumentet e tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus ndonjë shpenzim që i atribuohet drejtëpërdrejtë transaksionit.

Kompania fillimisht njihet të arkëtueshmet dhe depozitimet e parasë në datën kur ato janë krijuar-parimi aktual.Të gjitha pasuritë e tjera financiare njihen fillimisht me datën e tregtimit në të cilën kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Kompania ç'regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferohen të drejtat e marrjes së rrjedhës monetare nga pasuria financiare në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Kompania është i njohur si pasuri apo detyrim i veçantë.

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompenzohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur kompania ka të drejtë ligjore për të kompenzuar shumat ose të shlyej mbi një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyej detyrim në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivative të kompanisë përbëjnë të arkëtueshme të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera.

Instrumentet financiare

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasëpërfshijnë bilancet e parave të gatshme, llogaritë bankare dhe depozitat me afat .

Paraja e gatshme ruhet ne llogaritë bankare të bankave komerciale që funksionojnë në Kosovë.Risku është i shpërndarë në shumë banka.Menagjimi i parasë së gatshme bëhet në bazë të vendimeve,udhëzimeve dhe rregullave të shkruara.Në fund të vitit fiskal është bërë regjistrimi fizik i parasë së gatshme në arkë dhe barazimi formal midis librave kontabël dhe evidencës bankare.

Të arkëtueshmet dhe kërkesat tjera

Evidenca analitike e llogarive të arkëtueshme në bazë të shitjeve nga veprimtaria bazë mbahet në modulin e vecantë-Faturimi.

Vlerat e prezentuara në bilancin e gjendjes është paraqitur në vlera neto, duke zbritur provizionin për borxhet e këqija. Provizionimi është bërë me metodën e provizionimit të përgjithshëm. Provizionimi është bërë në bazë të rregullës për këtë qëllim dhe mbështetet në shkallët e provizionimit të lejuara dhe konform ligjeve në fuqi. Për provizionimin e borgjeve të këqija kemi siguruar të gjitha dëshmitë si: vërejtjet, thirrjet për pagesë, raportet e shkyqjeve, njoftimet përmes mediave, rastet që kanë shkuar te përmbaruesi. Duke u bazuar në vlerën e borgjeve të papaguara që i kemi ndjekur të gjitha procedurat sipas Ligjit Nr. 05/L-029 Për Tatimin në të ardhurat e korporatave kemi llogaritur vlerën **30,437 €** në emër të shpenzimeve të borgjit të keq.

Kërkesat tjera janë të përfaqësuara në një numër të caktuar të llogarive që përfaqsojnë Llogari të arkëtueshme mbi bazën e shitjeve të shërbimeve sekondare si: paradhënjet për investime kapitale, kërkesat ndaj personelit dhe kërkesat e pazbardhura pas vjedhjes së parasë në arkë, dhe të tjera të ndryshme.

Instrumentet financiare

Kapitali aksionar

Akcionari-përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës si akcionar i vetëm në vlerë totale ka lëshuar këto aksione përfshirë 25.000 aksione në vlerë nominale prej 1 € për çdo aksion. KRU "Prishtina" sh.a. posedon vendimin e aksionarit dhe çerifikatën e aksioneve.

Rezervat e rivlerësimit

Rezervat e rivlerësimit pasqyrojnë diferencën positive të vlerësimit të pasurive dhe humbjeve të bartura-përkatësisht fitimeve të pashpërndara në momentin e koorparatizimit. Rivlerësimi është bërë nga "Grant Thornton" dhe është funksional me gjendjen fillestare 01.01.2007

Pronat, Impiantet dhe paisjet maten me kosto duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshinë shpenzime që janë drejtëpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë .

Pronat, impianet dhe pajisjet

Pronat, Impiantet dhe paisjet maten me kosto historike duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshinë shpenzime që janë drejtëpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë.

Kosto e pasurive të vetëndërtuara përfshinë koston e materialeve dhe punës së drejtëpërdrejtë me vënien e pasurisë në gjendjen funksionale për përdorimin e synuar. Kur pjesë

të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ata kontabilizohen si zëra të veçantë të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të pasurive afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të pasurive dhe njihen neto si "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave (në fitim ose humbje).

Pronat në rrjedhën e ndërtimit për prodhim ose për qështje administrative ose për qëllime të papërcaktuara, barten në kosto, minus çdo humbje nga zhvlerësimi i njohur. Kosto përfshinë tarifën profesionale, kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të Kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre pasurive, në të njëjtën bazë si aktivet e tjera të pronësisë fillon kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar.

Pronat, impiantet dhe pajisjet

Mobilet, orënditë, pajisjet dhe automjetet paraqiten me koston e tyre duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe pa humbjet e akumuluar nga dëmtimet. Mobilet, orënditë, pajisjet dhe automjetet e KRU "Prishtina" sh.a. mbahen, menaxhohen dhe kontabilizohen në modulën e veçantë në kuadër të softërit "Navision".

Zhvlerësimi i aseteve është bërë në mënyrë drejtëvizore-lineare për të gjitha asetet. Normat e zhvlerësimit janë nxjerrë nga Ligji për Tatimin në të ardhurat e korporatave nr.03/L-162 të përkatësisht nën 15 pika 3.

Shpenzimet vjetore që njihen si shpenzime të zhvlerësimit për vitin 2018 kapin vlerën 6,539,319 euro ndërsa periudha TM2 e vitit 2019 është 3,269,660.00 euro.

Zhvlerësimi llogaritet në atë mënyrë që të zvogëlojë koston ose vlerësimin e pasurive, përveç Tokës dhe projekteve në ndërtim e sipër gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit duke përdorur metodën lineare si vijon:

- Ndërtesat dhe Rrjeti i Ujësjetës dhe kanalizimit	20 vite
- Impiantet dhe Makineritë	5-10 vite
- Mobilet dhe pajisjet	5 vite
- Automjetet	5-10 vite

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, shpenzimi ngarkohet prej muajit të blerjes e deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuar të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi me vlerësimet kontabël në të ardhmen.

Pasuritë e paprekshme

Fitimi ose humbja që vjen nga huthja ose asgjësimi i ndonjë pjese të pronave, impianteve ose pajisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një asemi dhe është e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë sipas rastit, sipas nevojës vetëm atëherë kur është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit do të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyrën e të ardhurave ose humbjeve dhe të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Njohja dhe matjet

Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat dhe programet kompjuterike. Këto pasuri të paprekshme janë paraqitur fillimisht me kosto dhe më pas me koston e tyre duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Amortizimi është njohur në bazë lineare përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim duke llogaritur në baza të ardhme.

Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese janë kapitalizuar vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë edhe për emrin e mirë të krijuar brenda, njihet në fitim apo humbje në momentin kur ndodhin.

Pasuritë e paprekshme

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e Pasurisë, duke i zbritur vlerën e saj të mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për softuer me një normë vjetore prej 20%.

Stoqet dhe inventarët

Stoqet dhe inventarët maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e tyre është e bazuar në parimin e "çmimit mesatar" dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara me rastin e blerjes së inventarëve, kostot e prodhimit apo të konvertimit dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Vlera neto

e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

Materialet dhe pjesët rezervë janë shpenzuar ose kapitalizua, kur instalohen.

Evidenca e stokeve të materialeve në depo mbahet në dy module të ndara;

1. Moduli i kontabilitetit material dhe financiar dhe
2. Modulin e kontabilitetit material-Depos.

Komisioni i vecantë në fund të vitit fiskal ka bërë regjistrimin përkatësisht numrimin – inventarizimin fizik stokeve dhe inventarëve. Komisioni qendror i regjistrimit ka parashtruar raportin përfundimtar.

Rënia në vlerë

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare janë vlerësuar për indikacione të rënies në vlerë në fund të çdo periudhe raportuese. Pasuritë financiare bien në vlerë kur ka një evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë financiare, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare të ardhshme të investimit janë ndikuar.

Humbja nga rënia në vlerë e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës së saj kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuara të ardhshme të skontuara me normën fillestare të ineteresit efektiv. Për pasuritë financiare të matura me kosto, vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare është llogaritur duke përdorur normën e tregut të kthimit për pasuri të ngjashme.

Pasuritë financiare të rëndësishme janë testuar për rënie në vlerë për baza individuale.

Pasuritë financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe që ndjanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje). Humbja nga rënia në vlerë rimirret nëse ky kthim mund të lidhet objektivisht me një ngjarjepasi humbja nga rënia në vlerë është njohur. Për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar kthimi është njohur në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Pasuritë jo financiare

Në fund të çdo periudhe raportimi, kompania rishikon vlerat kontabël të pasurive të saj jo financiare për të përcaktuar nëse kanë pësuar një humbje nga rënia në vlerë.

Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë në mënyrë që të përcaktohet shkalla e humbjes (nëse ka). Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është shuma më e madhe në mes të vlerës së saj në përdorim ose vlerës së saj të drejtë minus kostot për shitje.

Rënia në vlerë

Pasuritë jo financiare

Në vlerësimin e vlerës në përdorim , flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për kompaninë. Për qëllim të testimit të rënies në vlerë pasuritë grupohen së bashku në grupin më të vogël të pasurive që gjeneron flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhduar që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të pasurive tjera ose grupeve të pasurive.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme . Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje).

Grantet Qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet.

Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ do të ishte ngarkuar, nëse granti nuk ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompenzim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzime të lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm.

Grantet Qeveritare

Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si grant qeveritar i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

KRU "Prishtina" sh.a. edhe gjatë vitit 2018 ka njohur të hyra të shtyera dhe ka njohur grante. Grantet kanë qenë të orientuar në zgjerimin e rrjetës së ujësjellësit dhe në ndertimin e Fabrikes së re në Shkabaj si dhe në fusha të tjera.

Gjatë vitit aktual janë njohur si të hyra nga grantet e shtyera vlera prej 1,267,071€, njejtë vlerë është përlogaritur edhe si shpenzim operativ (zhvlerësimi i aseteve) përkatësisht shpenzime operative të mirembajtjes.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare përfshijnë huamarrjet dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera që maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme (duke përfshirë të gjitha shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërse të normës së interesit efektiv, koston e transaksionit dhe promitë e tjera ose uljet) nëpërmjet jetës së detyrimit financiar, ose sipas rastit një periudhë më të shkurtër, në vlerën bartëse neto në njohjen fillestare.

Njohja e të hyrave

Të ardhurat njihenme vlerën e drejtë të marrë ose të arkëtueshme.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshinë kryerjen e shërbimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, të ardhurat e lidhura me transaksionin do të njihen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese. Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet i besueshëm kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- a) Shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme
- b) Është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike.

Njohja e të hyrave

- c) Faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet në mënyrë të besueshme dhe
- d) Kostot shkaktuara për transaksionin dhe koston për të përfunduar transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme

Përfitimet e punëtorëve

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit vendor. Shpenzimet e bëra në emër të Kompanisë janë ngarkuar në pasqyrave të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjente njihen kur Kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundshme që Kompania do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm nuk mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

Shuma e njohur si detyrim kontigjent është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit, duke marrë parasyshë rreziqet dhe pasiguritë që e rrethojnë detyrimin. Kur një provizion matet duke përdorur rrjedhat e vlerësuara të flukseve monetare të nevojitura për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e këtyre flukseve të mjeteve monetare (kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet që të rikthehen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si pasuri nëse është pothuajse e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kontratat me kushte të pavoritshme

Detyrimet aktuale që lindin nën kontratat me kushte të pavoritshme njihen dhe maten si provizione. Një kontratë me kushte të pavoritshme është konsideruar të ekzistojë kur Kompania ka një kontratë në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të pranohen nga kontrata.

Para se një provizion i veçantë për një kontratë me kushte të pavoritshme është themeluar, një kompani njeh çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur mbi pasuritë dedikuara për këtë kontratë.

Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi llogaritë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihenkur ato ndodhin në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje), duke përdorur metodën e interesit efektiv . Shpenzimet finciare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huazimet dhe humbjet nga rënia në vlerë të njohura si pasuri financiare (nëse ka).

Shpenzimet e huamarrjes

Kostot e huamarrjes drejtëpërdrejtë të atribueshme për blerjen, ndërtimin ose prodhimin e pasurive të ndërlidhura, të cilat janë pasuri që domosdoshmërisht marrin një kohë të gjatë për të gjen të gatshme për përdorimin e tyre të synuar ose të shitjes, janë shtuar në koston e këtyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar apo për shitje.

Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Tatimi

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm dhe tatimin e shtyer. Shpenzimi mbi tatimin në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëratë njohur direkt në kapital ose në të ardhura tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet për tu paguar ose arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën kompania pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyej vlerën kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë është matur nën omra të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur atondryshojnë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si emiruar në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë njihet si pasuri për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit do të përdoret ndryshimi i përkohshëm. Tatimi i shtyrë si pasuri rishikohet në secilën datë të raportimit dhe reduktohet në masën që kjo nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen. Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Kompania merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesat të tjeramund të ngarkohen. Kompania beson që shumat e njohura për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e shumëfaktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit tatimor dhe përvojë paraprake. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një seri të vendimeve rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni ri mund të jetë në dispozicion që i shkakton Kompanisë për të ndryshuar vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tilla të detyrimeve tatimore do të ndikojnë në shpenzimin për tatimin në periudhën që një përcaktim i tillë është bërë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe shpalosjet e kontabilitetit të Kompanisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për të dyja, pasuritë dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe të shpalosjes duke ubazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme informacioni imëtejshëm mbi supozimet e bëragjatë përcaktimit të vlerave reale është shpalosur në detyrimet specifike të pasurisë ose detyrimit përkatës.

Të arkëtueshmët tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, llogaarit si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, skontuar me normën e interesit të tregut për pasuritë ngjashme në datën e raportimit.

Detyrimet financiare joderivative

Vlera e drejtë, e cila është e përcaktuar për qëllime të shpalosjes, llogaitet në bazë të vlerësaktuale të rrjedhave monetare të principalit dhe interesit, të zbritur për normën etregut të interesit në datën e raportimit.

Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Vlerësimet dhe gjykimet risshikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historikedhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilatbesohen të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Kompania bën vlerësime dhesupozime në lidhje me të ardhën. Përcaktohet që, vlerësimet e kontabilitetit shumërrallë do të jenë të barabartë me rezultatet e ndërlidhura aktuale. Vlerësimet dhesupozimet që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shaktuar një rregullim materialte shumat bartëse të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë.

Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Jetët e dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në shënimin 3.6. më sipër; Kompania rishikon jetëgjatësinë e pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktor të tjerë mund të ndikojnë në jetë të dobishme të pasurive dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnë vlerët konsiderueshme vlerën kontabël neto të pasurive.

Provizionet për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të shlyerjes së inventarëve Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësimin për rikthimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti njehnjë provizion të përshtatshëm për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të inventarëve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Tatimi

Ngarkesa e tatimit të Kompanisë në aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shlyera. Llogaritja e pagesës totale tatimore të Kompanisë domosdoshmërisht përfshinë një shkallë të vlerësimit dhe gjyimit në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilëve nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa është arritur një rezolutë me autoritetin tatimor përkatës, ose, sipas rastit, nëpërmjet një procesi formal ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të ketë ndikim material në pasqyrën e të ardhurave të tjeragjithëpërfshirëse dhe/ose variancave në rrjedhën e pasasë.

***PASURITË E PAPREKSHME**

<i>Pasuritë e pa Prekshme</i>	<i>Blerjet 2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>Softëare</i>	18,644	
<i>Paisjet e IT-se</i>	62,939	
Total	81,583	

***INVENTARI**

	<i>Blerjet 2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>G-Paisjet e Makinerise 20 %</i>	1,686,751.22	1,782.71
<i>H-Paisjet e Mirembajtjes 20 %</i>	238,039.50	322,000
<i>I -Automjetet 20%</i>	2,800	0
<i>K- Paisjet e Zyreve 20%</i>	225	0
<i>L- Mobiljete e Zyreve 20%</i>	5,677	235.9
Total	1,933,493	324,018.61

	<i>Zhvlerësimi- 2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>A-Toka 0 %</i>		
<i>B-Ndertesatdhestrukturat ndertimore-5 %</i>	1,196,045	433,210
<i>C-Rrjeta e Ujesjellesit-5%</i>	2,797,776	821,212
<i>D-Rrjeta e ujeravetendotura 5%</i>	479,046	249,301
<i>E-Kyqjet ne Ujesjelles 5%</i>	192,116	100,724
<i>F-Ujematesit 20 %</i>	485,384	740,622
<i>G-Paisjet e Makinerise 10%</i>	989,606	9,986
<i>G-Paisjet e Makinerise 20 %</i>	49,928	17,236
<i>H-Paisjet e Mirembajtjes 20 %</i>	35,254	81,902

KRU "Prishtina" sh.a.-Shpalosjet TM2-Janar-Qershor-2019

<i>I -Automjetet 20%</i>	108,234	56,941
<i>J- Paisjet e TI 20%</i>	178,439	142,148
<i>K- Paisjet e Zyreve 20%</i>	12,424	37,907
<i>L- Mobiljete e Zyreve 20%</i>	15,066	40,966
<i>Paisjeve elektromakinerike</i>		424,644
<i>Akumuluar Shtese 2014</i>		79,576
<i>Amortizimi i akumuluar i Softwerit</i>		30,168
<i>Objekteve ndert.nentoksore</i>		3,118
Total	6,539,319.55	3,269,660

*** LLOGARITË E ARKËTUSHME TREGTARE**

<i>Llogarite e arketueshme</i>	<i>2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>Bleresit e sherbimeveteFaturimit</i>	46,342,198.39	47,221,933
<i>Falja e Borxhevesipasligjit (2016-2017)</i>	8,648,529.88	8,648,529.88
<i>Korigjimi i vleres se llogtearketu.</i>	-41,508,912.14	-41,539,349.14
<i>Sherbimet -Shitjettjera</i>	139,510.20	139,510.20
Total	13,621,326.33	14,440,187

*** TE ARKËTUESHMET TJERA**

<i>Tearketueshmetjera</i>	<i>2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>Paradheniet-avanset</i>	7,216.71	7,216.71
<i>Paradhenie per investimekapitale</i>	571,965.86	649,024.00
<i>Paradhenjet per sigurimin e automjeteve</i>	19,233.36	7,740.73
<i>Paradhenjet per qira</i>	28,781.42	32,491.29
<i>Paradhenjet per sherb.teinternetit-Kujtesa</i>	48.56	48.56
<i>Paradhenie per Tatim ATK</i>	117,082.44	117,082.44
<i>Paradhenjet per fazen e dyte-KFË</i>		
<i>Bleresit-Shitjettjera</i>	106,038.49	106,038.49
<i>Kyqja ne rrjetin e UjesjellesitdheKanalizimit</i>	6,702.40	6,702.40
<i>Kerkesatndaj ATK-se (2001-2010)</i>	647,888.55	647,888.55
<i>KerkesatndajGrantitFaza II-KFË(10862500.00)</i>	161,000.00	25,406.80
<i>KerkesatndajKredise-Faza II KFW(6 Milion)</i>		

KRU "Prishtina" sh.a.-Shpalosjet TM2-Janar-Qershor-2019

<i>Kerkesa per kamatedhedividente</i>	11,502.57	3,312.57
<i>Kerkesandajpersonelit</i>	10,524.32	4,664.87
<i>Ndalesa per Materiale</i>	7,473.04	6,827.04
<i>Kerkesattjerpunetoreve</i>	87,332.89	87,432.89
<i>(akontacion,kredi,kusur)</i>		
<i>KerkesatTjera(Vjedhja e Arkes)</i>	67,002.67	67,002.67
<i>Rezervimet per qirane e papaguar</i>	814.9	814.9
Total	1,850,608.18	1,769,694.91

*** PARAJA E GATSHME DHE NE BANKË**

** PARAJA E GATSHME DHE NË BANKË* 31.12.2018 tm2-2019

<i>Parajanëarka</i>	4,389	19,734.51
<i>Parajanë Banka</i>	4,316,262	4,403,880
Total	4,321,100	4,423,615

*** KAPITALI AKSIONAR**

KAPITALI AKSIONAR	31.12.2018	Tm2-2019
	25,000	25,000
 <i>Rezervat</i>		31.12.2018 Tm2-2019
Total		72,710,754 72,710,754

Më 30.06.2019 KRUP sh.a.përmban 100% të kapitalit aksionar të kompanisë. Pronari i vetëm i KRUP SH.A është Qeveria e Republikës së Kosovës.

*** REZERVAT E TRANSFERIT**

* REZERVAT E TRANSFERIT	31.12.2018	tm2-2019
<i>Toka</i>		18,502,200
	18,502,200	
<i>Pasuri e Patundshme-Servituti Toksor</i>	552,546	568,020
<i>Ndërtesat dhe Strukturandërtimore</i>		24,642,800
	24,553,594	
<i>Rrjeta e ujësjellësit</i>		58,628,645
	58,469,504	
<i>Rrjeti i ujëravetëndotura</i>		10,423,993
	10,423,992	
<i>Kyqjetnërrjetin e ujësjellësit</i>		3,842,315
	3,842,315	
<i>Ujëmatësar</i>		4,438,580
	4,436,520	
<i>Objektetndërtimorenëntokësore</i>		829,868
	818,575	
<i>Total</i>	121,599,246	121,876,421

Stoqet

<i>Stoqet</i>	2018	tm2-2019
<i>Materialihargjues</i>		
	1,405,036	1,387,482
<i>Lendetdjegese</i>		
	37,098	(14,228)
<i>Inventari i imet</i>		
	15,175	16,603
<i>Auto gomat</i>		
	829	829
<i>Materiali i zyreve</i>		
	1,891	1,457
<i>Pjesetrezerve</i>		
	10,054	10,054
<i>Materialihargjues per kemikaljedhereagencia</i>		
	0	1,635
<i>Materialet e dhuruara (Donacion)</i>		
	358	358

KRU "Prishtina" sh.a.-Shpalosjet TM2-Janar-Qershor-2019

<i>Kalkulimi i Blerjeve</i>	(39)	(39)
<i>Materiali i ndryshem ne depo-Podujeve</i>	15,295	15,295
<i>Material i ndryshem ne depo-Lipjan</i>	23,441	23,441
<i>Materiali i ndryshem ne depo-Drenas</i>	41,819	41,819
<i>Dallimet ne çmime</i>	(20,421)	(20,421)
<i>Inventari i imet ne perdorim</i>	61,544	61,544
<i>Autogomate ne perdorim</i>	10,098	10,098
Totali	1,602,177.76	1,535,927.75

*** GRANTET E SHTYERA**

KRU "Prishtina" sh.a. edhe gjatë vitit 2019 ka njohur të hyra të shtyera dhe ka njohur grante. Grantet kanë qenë të orientuar në zgjerimin e rrjetës së ujësjellësit dhe në ndertimin e fabrikes se re ne Shkabaj si dhe në fusha të tjera në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit vite me radhë. Gjatë vitit aktual janë njohur si të hyra nga grantet e shtyera vlera prej **1,267,071.00€**, njejt vlerështë përlllogaritur edhe si shpenzim operativ (zhvlerësimi i aseteve) përkatësisht shpenzime operative te mirembajtjes.

TE HYRAT NGA GRANTET	31.12.2018	Tm2-2019
TOTAL	2,149,196	1,267,071

TE HYRAT TJERA OPERATIVE

TE HYRAT TJERA OPERATIVE	31.12.2018	Tm2-2019
TOTAL	43,539	81,461

Të hyrat nga shërbimi i ujit dhe ujërave të ndotura

KRU "Prishtina" sh.a. menagjimin e faturave për shitjen e ujit dhe ujërave të ndotura e bënë me modulën e faturimit.

Tarifa për ujë dhe ujëra të ndotura zbatohet si e tillënë vlerat që ka miratuar Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina.

Faturimi bëhet mbi bazën e leximit tëmatësve të ujit përkatësisht metodës afforfe për konsumatorët që nuk kanë ujëmatës-përkatësisht nuk mund të bëhet leximi i të njëjtit.

<i>Te hyrat nga faturimi</i>	5,570,004
<i>Te hyrat nga faturimi per kanalizim</i>	631,395
<i>Te hyrat nga taksa fikse</i>	906,380
<i>Te hyrat tjera nga Faturimi</i>	46,592
Total	7,154,371

*** KREDIA NGA KFW**

Fitimi përkatësisht humbja e vitit fiskal

Fitimi per periudhen 2019 eshte pas tatimit në fitim 70,581.00. Kompania ka realizuar të gjitha aktivitetet gjatë vitit dhe ka shtuar vleren e ndërmarrjes dhe ka dalur me fitim.

* KREDIA NGA KFW	31.12.2018	tm2-2019
<i>Long term loan from Kfw(6 Mil)</i>	6,000,000	6,000,000
<i>Long term loan from Kfw - (20Mil)</i>	12,223,000	11,112,000

	31.12.2018	30.06.2019
<i>Fitimi-Humbja operative</i>	(751,015)	70,581
<i>Tëhyratngainteresinëdepozitatbankare</i>	13,062.57	15,180
<i>Fitimi-Humbja para tatimit</i>	(751,015)	78.423
<i>Shpenzimet e tatimitnëfitim</i>	0	-7,842
<i>Fitimi / Humbja e vitit</i>	(751,015)	70,581

Shpenzimet vjetore të amortizimit dhe zhvlerësimit

Assetet e KRU "Prishtina" sh.a. mbahen, menaxhohen dhe kontabilizohen në modulën e vecantë në kuadër të softuerit "Navision"

Zhvlerësimi i aseteve është bërë në mënyrë drejtëvizore-lineare për të gjitha assetet.

Normat e zhvlerësimit janë nxjerrë nga Ligji për Tatimin në të ardhurat e korporatave nr.03/L-162 të përkatësisht nenin 15 pika 3.

Shpenzimet vjetore që njihen si shpenzime të zhvlerësimit për vitin 2018 kapin vlerën 6,539,319.00€uro ndërsa gjysmën e parë të vitit 2019 janë : 3,269,660.

<i>Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit</i>	<i>31.12.2018</i>	<i>Tm2-2019</i>
TOTAL	(6,539,319)	(3,269,660)

Shpenzimet e borxhit të keq

Vlera e borxhit të keq e prezentuara në Pasqyrën e të ardhurave është treguar në vlerë neto, duke zbritur tatimin në vlerë të shtuar.

Borxhi i keq është bërë me metodën e provizionimit të përgjithshëm.

Për provizionimin e borgjeve të këqija kemi siguruar të gjitha dëshmitë si: vërejtjet, thirrjet për pagesë, raportet e shkyqeve, njoftimet përmes mediave, rastet që kanë shkuar te përmbaruesi. Duke u bazuar në vlerën e borgjeve të papaguara që i kemi ndjekur të gjitha procedurat sipas Ligjit Nr. 05/L-029 Për Tatimin në të ardhurat e korporatave kemi llogaritur vlerën 30,437€ në emër të shpenzimeve të borxhit të keq, ndërsa për periudhën TM2-2019, është 15,219.

<i>Shpenzimet e provizionimit të borxhit të keq</i>	<i>31.12.2018</i>	<i>Tm2-2019</i>
TOTAL	(30,437)	(15,219)

*** LLOGARITE E PAGUESHME TREGARE DHE TE TJERA**

<i>Llogarite e pagueshme</i>	<i>2018</i>	<i>Tm2-2019</i>
<i>Furnitoret nga afarizmi i rregullt</i>	1,378,362	1,442,331

Detyrimet ndaj furnitorëve për veprimtarinë e rregullt të KRU "Prishtina" sh.a. përfaqsojnë kryesisht detyrimet e muajve të fundit për të cilat nuk ka skaduar afati i pagesës apo nuk janë kryer punimet në teren. (Parimi i aktualitetit)

Pagat e pagueshme dhe tatimi i pagueshem-TVSH

Pagat e pagueshme përfshirë tatimet dhe kontributet nga pagat janë në vlerë prej 835,847.00 €, ndërsa për periudhën TM2-2019, është 787,388 të cilat pritet të paguhet pas skadimit të vitit fiskal (parimi i aktualitetit).

KRU "Prishtina" sh.a. ka paguar të gjitha tatimet si tatim në burim në paga kontributet pensionale si dhe tvsh mbi bazën e inkasimit, kjo e fundit e mbështetur në vendimin e ATK –se që TVSh të paguhet në inkasim.

Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe ndërmarrjet publike kanë realizuar një marrëveshje mirëkuptimi me të cilën këto të fundit obligohen për pagesën e Tatimit mbi bazën e faturave të arkëtuara.

PAGAT DHE TATIMI I PAGUESHEM		31.12.2018	Tm2-2019
<i>Total</i>		835,847	787,388

<i>Shpenzimet e personeli</i>	31.12.2018	Tm2-2019
<i>Total</i>	5,137,160	2,723,361

Resurset njerzore përkatësisht pagat e tyre menagjohen me modulën e veçantë në kuadër të softuerit "Navision".

Kalkulimi dhe pagesa e pagave bëhet në bazë të kontratës individuale.

Pagat bruto i nënshtrohen të gjitha tatimeve dhe taksave të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu shtesat dhe kompenzimet tjera paguhet në përputhje me Kontratën kolektive dhe Rregulloren mbi Ligjin themelor të punës në Kosovë.

Distribuimi dhe Faturimi në m3

	31.12.2018	Tm2-2019
<i>Distribimi i ujit m3</i>	51,743,595	25,850,562
<i>Faturimi i ujit m3</i>	21,841,206	11,138,554
<i>Humbjet</i>	58%	%57

Shpenzimet per blerje te ujit te paperpunuar

<i>31.12.2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>642,196</i>	<i>343,820</i>

Shpenzimet e energjise elektrike

<i>31.12.2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>2,312,212</i>	<i>1,102,218</i>

Shpenzimet e karburanteve

<i>31.12.2018</i>	<i>tm2-2019</i>
<i>117,861</i>	<i>57,108</i>

Shpenzimet e materialeve për mirëmbajtje

Shpenzimet e materialeve dhe pjesëve të ndërrimit për mirëmbajtjen e rrjetit dhe makinerisë përfaqsojnë një kategori thelbësore të shpenzimeve. Këto shpenzime adresohen përmes procedurës së hyrje-daljeve në depon qendrore (Prishtinë) dhe depove që aktualisht kanë mbetur nëpër NJOU-të.

<i>Shpenzimet e Materialit Harxhues</i>	<i>92,709</i>
<i>Shpenzimet e mjeteve te mbrojtjes ne pune-depo</i>	<i>13,340</i>
<i>Shpenzimet e inventarit te imte-depo</i>	<i>13,599</i>
<i>Shpenzimet e autogomave-depo</i>	<i>5,450</i>
<i>Shpenzimet e materialit administrativ-depo</i>	<i>1,790</i>
<i>Shpenzimet e pjeseve rezerv-depo</i>	<i>1,566</i>
<i>Shpenzimet e materialit-kemikalje dhe reagenca</i>	<i>12,366</i>
<i>Shpenzimet per analiza shendetsore -punesuarit</i>	<i>1,800</i>
<i>Shpenzimet transportit publik vajtje-ardhje n'pune</i>	<i>4</i>
<i>Shpenzimet transportit,fjetjes n'udhetime zyrtare</i>	<i>4,453</i>
<i>Shpenzimet e akomodimit gjate udhetimit zyrtar,</i>	<i>3,352</i>
<i>Shpenzimet tjera gjat udhtimit zyrtar dhe akomodim</i>	<i>5,367</i>
Total	155,796

Shpenzimet e jashme kontraktuese

Përfaqsojnë një kategori të madhe dhe të shumëllojshme të shpenzimeve që palët e treta bëjnë në interes të KRU "Prishtina" sh.a. duke potencuar disa: Tatimi në pronë, Taksa vjetore e licencimit-ZRRUM, Anëtarësitë, Sigurimi fizik i objekteve etj (shiko tabelën).

<i>Shpenzimet e telefonise fikse</i>	1,317
<i>Shpenzimet e telefonise mobile-Vala</i>	5,662
<i>Shpenzimet e telefonise mobile-Internet</i>	3,763
<i>Shpenzimet tjera per PTK dhe postave tjera</i>	128
<i>Shpenzimet e licences per ZRRUM</i>	80,227
<i>Shpenzimet e interesit</i>	217,465
<i>Tatimi ne prone</i>	2,700
<i>Tatimi ne fitim</i>	1,092
<i>Tatimi ne burim per qira,lojera fati etj</i>	2,831
<i>Shpenzimet e doganes</i>	99
<i>Sherbimet e jashtme kontraktuese</i>	839
<i>Taksa-Tarifa menaxhuese e kredise</i>	201
<i>Anetarsia ne SHUKOS</i>	7,800
<i>Anetarsia ne organizata regjionale-nderkombetare</i>	3,920
<i>Shpenzimet e barjes se mbeturinave</i>	5,370
<i>Shpenzimet e Ujit per pije</i>	55,586
<i>Shpenzimet e ushqimit-mbi pagesen e rregullt</i>	541
<i>Shpenzimet e reprezentacionit</i>	4,813
<i>Shpenzimet e byfese</i>	871
<i>Shpenzimet per sigurimin fizik te objekteve</i>	153
<i>Sherbimet e ndryshme kontrakturse (Sig.per qkyqje)</i>	2,288
<i>Shpenzimet per marrjen me qera te objekt.ndertimor</i>	21,305
<i>Shpenzimet per marrjen me qera te tokës</i>	255
<i>Shpenzimet per marrje me qera te TI (fotokopje,)</i>	4,995
<i>Shpenzimet per marrjen me qera te paisjeve tjera</i>	350
<i>Shpenzimet per sigurimin e automjeteve</i>	9,454
<i>Shpenzimet per rexhistrimin e automjeteve</i>	2,569
<i>Taksa komunale per shfrytezimin e rrugeve publike</i>	90
<i>Taksa rrugore e Republikes se Kosoves</i>	1,650
<i>Taksa ekologjike</i>	480
<i>Shpenzimet per transfere te transakcioneve bankare</i>	47,199
<i>Shpenzimet e shkollimit</i>	1,177
<i>Shpenzimet e trajnimit,seminare,kotizim etj</i>	870
<i>Shpenzimet per perfaqsimin ligjor-avokati,auditimi</i>	10,938
<i>Shpenzimet e reklames dhe propagandes</i>	825
<i>Shp. e denimeve, penaleve, gjobave,interesave etj.</i>	207,466
<i>Shp. e shpronsimit-Servitutet(Fabrika e re)</i>	376

KRU "Prishtina" sh.a.-Shpalosjet TM2-Janar-Qershor-2019

<i>Shpenzimet e byfese</i>	3,267
<i>Shpenzimet per taksa gjyqesore dhe administrative</i>	39
Total	710,970

Shpenzimet e rekreacionit , sportit dhe ndihmave solidare

<i>Shpenzimet e pervjetoreve, dhuratave, inaugurimeve</i>	1,603
<i>Shpenzime per aktivitete sportive</i>	80
<i>Shpenzime te ndihmave solidare(pensione,donacione,</i>	1,235
<i>Shpenzimet e ndihmave solidare-jashte mdermarrjes</i>	500
Total	3,418

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit

Shpënzimet e mirëmbajtjes dhe riparimet nga demtimet eventuale janë sipas bartësve në vijim:

<i>Objektet ndertimore</i>	3,508
<i>Paisjeve</i>	23,886
<i>Automjetet</i>	24,658
<i>Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit-TI</i>	222
<i>Shpenzimet e mirembajtjes dhe rip. te automjeteve</i>	139
<i>Mirmbajta e paisjeve-montim dhe demontim</i>	3,850
Total	56,264

Te dalurat financiare dhe transferi i rezultatit financiar

<i>Shpenzimet e ndryshme</i>	1,255
<i>Shpenz.gjyqesore-administrative dhe taksa tjera</i>	572
Total	1,827